

**DOKUMENT I BANKËS EVROPIANE  
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

**STRATEGJIA PËR SHQIPËRINË**  
**Aprovuar nga Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e datës 13**  
**Janar 2016**

*Përkthimet e tekstit origjinal janë siguruar nga BERZH vetëm për lehtësi leximi. Ndërsa BERZH është kujdesur në mënyre të veçantë për të siguruar vërtetësinë e përkthimit, BERZH nuk garanton ose vërteton saktësinë e përkthimit. Risku për përdorimin e tekstit të përkthyer qëndron mbi vetë lexuesin. Në asnjë rrethanë, BERZH, punonjësit e Bankës dhe agjentët nuk janë përgjegjës ndaj lexuesit ose ndaj çdo personi tjetër për çdo pasaktësi, gabim, përjashtim, heqje, defekt dhe/ose çdo ndryshim të përmbajtjes së përkthimit, pavarësisht shkakut ose për çdo dëm që rezulton prej tij. Në rast të çdo mosperputhjeje ose kundërshtimi ndërmjet versionit anglisht dhe atij të përkthyer, version anglisht merret për bazë.*

## Pasqyra e Lëndës

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>3</b>
<b>1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI AKTIVITETET E BANKËS .....</b>	<b>5</b>
1.1 PORTOFOLI AKTUAL I BANKËS .....	5
1.2 ZBATIMI I DREJTIMEVE STRATEGJIKE TË MËPARSHME.....	5
1.3 MËSIMET KYÇE TË NXJERRA .....	7
<b>2 MJEDISI OPERACIONAL .....</b>	<b>8</b>
2.1 KUADRI POLITIK .....	8
2.2 KUADRI MAKROEKONOMIK.....	9
2.3 KONTEKSTI I REFORMËS STRUKTURORE.....	11
2.4 MJEDISI I BIZNESIT DHE KUADRI LIGJOR.....	11
2.5 AKSESI NË FINANCA .....	12
2.6 KUADRI SOCIAL .....	15
2.7 KUADRI I EFICENCËS ENERGETIKE DHE NDRYSHIMEVE KLIMATERIKE.....	16
<b>3 ORIENTIMET STRATEGJIKE.....</b>	<b>17</b>
3.1 DREJTIMET STRATEGJIKE .....	17
3.2 SFIDAT KYÇE DHE AKTIVITETET E BANKËS .....	18
3.3 RREZIQET POTENCIALE PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË SË VENDIT .....	28
3.4 IMPLIKIME MJEDISORE DHE SOCIALE TË AKTIVITETEVE TË PROPOZUARA TË BANKËS .....	28
3.5 BASHKËPUNIMI I BERZH-IT ME MDB-TË .....	30
<b>SHTOJCA 1 – VLERËSIMI POLITIK.....</b>	<b>32</b>
<b>SHTOJCA 2 – TREGUES SË PËRZGJEDHUR EKONOMIKË.....</b>	<b>39</b>
<b>SHTOJCA 3 – VLERËSIM I SFIDAVE TË TRANZICIONIT .....</b>	<b>40</b>
<b>SHTOJCA 4 – TRANZICIONI LIGJOR.....</b>	<b>46</b>
<b>SHTOJCA 5 – PROFILI GJINOR .....</b>	<b>51</b>
<b>SHTOJCA 6 – BERZH-I DHE KOMUNITETI DONATOR.....</b>	<b>53</b>

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shqipëria është e angazhuar dhe po aplikon parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizmit dhe ekonomive të tregut në përputhje me kushtet e specifikuar në Nenin 1 të Marrëveshjes Themeluese të Bankës.

Në periudhën që prej krijimit të Strategjisë së mëparshme, Shqipëria ka bërë progres të mëtijshëm në reformën demokratike, në një masë të madhe shtyrë nga integrimi në BE. Shqipëria mori zyrtarisht statusin e shtetit kandidat për në BE në qershor të 2014-ës.

Performanca ekonomike është përmirësuar pak në vitin 2014, por rritja mbetet e ngadaltë që prej vitit 2012. Rritja e PBB-së në tri vitet e fundit (2012-14) ishte nën 2 përqind, më shumë se 1 pikë përqindje më e ulët krahasuar me mesataren e periudhës 2009-11, dhe më shumë se 4 pikë përqindje më e ulët krahasuar me periudhën trevjeçare përpara krizës globale të vitit 2008. Pas vetëm një përqind rritjeje në vitin 2012, ekonomia u rrit pak në periudhën 2013-14, po rimëkëmbja mbeti e ngadaltë. Ngadalësimi i kohëve të fundit ka reflektuar si problemet e brendshme, përkatësisht pagesat e prapambetura për bizneset nga qeveria, reduktim i lehtë i portofolit të huave, rritjen negative të kreditimit në bazë vjetore për sektorin privat dhe nivelin e lartë të huave të këqija, dhe vështirësitë me partnerët më të rëndësishëm ekonomikë të Shqipërisë, Italinë dhe Greqinë. Pas një deficiti fiskal prej më shumë se 5 përqind të PBB-së gjatë dy viteve të fundit, raporti i borxhit publik me PBB-në ka arritur më shumë se 70 përqind të PBB-së, nivel i konsideruar i lartë bazuar në standardet rajonale, por ka shenja që mund të jetë arritur piku, falë progresit në konsolidimin fiskal. Rritja ka të ngjarë të rimëkëmbet në vitin 2015 në 2.5 përqind dhe në nivelin 3-4 përqind në vit për periudhën 2016-18. Megjithatë, rreziqet janë të larta. Ekonomia është ende me defiqite binjake të mëdha dhe sektori financiar vijon të ekspozohet si ndaj rreziqeve të brendshme edhe ndaj rreziqeve të jashtme.

Në aspektin strukturor, Shqipëria ka bërë progres gjatë viteve të fundit në trajtimin e disa prej problemeve më të rrënjosura të saj. Vendi po përfiton nga një moment i ripërtërirë reformash, i synuar kryesisht për përmirësimin e mjedisit të përgjithshëm të biznesit, duke trajtuar sfidat në sektorin energjetik dhe duke harmonizuar organizimin bashkiak. Perspektiva e pranimit në BE jep një mundësi të fortë për vijimësinë e kësaj tendence. Paralelisht, integrimi rajonal në Ballkanin Perëndimor dhe marrëdhëniet e rajonit me BE-në po përfitojnë nga një shtysë e re politike. Kjo pritet të ofrojë një mjedis mbështetës për aktivitetet e Bankës gjatë katër viteve në vijim. Në të njëjtën kohë, sfidat mbeten domethënëse. Prodhimi me vlerë të shtuar të ulët zë një pjesë të mirë të ekonomisë, ndërsa ndërmjetësimi financiar pengohet nga nivelet shumë të larta të huave të këqija, të cilat, nga ana e tyre pengojnë konkurrueshmërinë e sektorit privat. Kjo situatë komplikohet nga historia e izolimit të Shqipërisë përpara 1991-it, e cila la trashëgim infrastrukturë, investime dhe lidhje tregtare të kufizuara me rajonin e gjerë. Për më tepër, ndërmarrjet energjetike dhe infrastrukturale bashkiake nuk operojnë në bazë të qëndrueshme. Në këtë kuadër propozohen orientimet e mëposhtme strategjike për të përforcuar angazhimin e BERZH-it në Shqipëri gjatë periudhës së strategjisë së ardhshme:

- **Mbështetje e konkurrueshmërisë së sektorit privat duke zgjeruar krijimin e vlerës, lehtësuar aksesin e SME-ve në financime dhe forcuar një mjedis mundësues biznesi:** Kushtet për të bërë biznes vazhdojnë të jenë sfiduese. Në veçanti SME-të po luftojnë për shkak të kombinimit të aksesit të kufizuar në financa, korrupsionit dhe pasigurisë për çështjet e të drejtave të tokës dhe pronësisë. Aktivitetet informale janë të përhapura gjerësisht, duke penguar përpjekjet e

kompanive që janë të gatshme të zbatojnë rregullat dhe të funksionojnë sipas ligjeve. Banka do t'i mbështesë korporatat dhe SME-të në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet financimit të borxhit dhe financimit të kapitalit; si dhe do të ofrojë këshillim për biznesin, me synimin e forcimit të konkurrueshmërisë ndërmjet ndërmarrjeve nëpërmjet përmirësimit të aftësive, investimeve në teknologjitë moderne, investimeve me efikasitet energjetike dhe të qëndrueshme, qeverisjes së mirë, praktikave dhe standardeve më të mira të biznesit. Banka do të përpiqet po ashtu të ndihmojë për rifillimin e kreditimit për sektorin privat nëpërmjet produkteve me ndarje rrisht dhe linja të dedikuara kreditimi me bankat tregtare, dhe nëpërmjet angazhimit në këshillim për politikën për zgjidhjen e huave të këqija. Së fundmi, duke përdorur në maksimum momentin e ripërtëritë të reformave nga autoritetet, Banka do të zgjerojë aktivitetet e saj nën Nismën për Klimën e Investimeve dhe Qeverisjen (ICGI).

- **Zgjerim i tregjeve duke forcuar lidhjet rajonale:** Si ekonomi e vogël, e hapur, Shqipëria mund të përfitojë shumë nga zgjerimi i lidhjeve ekonomike me vendet fqinje, duke u mbështetur në frymën pozitive të bashkëpunimit rajonal që ka marrë jetë vitet e fundit. Nevojitet një qasje gjithëpërfshirëse rajonale për përmirësimin e infrastrukturës ndërkufitare, lidhjeve energjetike dhe uljen e pengesave jotarifore për tregëtinë. Për t'i trajtuar këto nevoja, Banka do të punojë ngushtë me BE dhe partnerët e tjerë të saj në Kuadrin e Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF), e cili gjithnjë e më tepër po i jep rëndësi projekteve që nxisin konektivitetin. Në veçanti, Banka do të kërkojë mundësi për të mbështetur zgjerimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës rajonale të transportit për të lehtësuar lidhjet ndërkufitare dhe për të ulur kostot e transportit. Për të forcuar sigurinë energjetike, ajo do të mbështesë dhe interkoneksionet energjetike dhe të gazit me vendet fqinje. Banka do të mbështesë po ashtu investitorët e huaj në Shqipëri dhe do të lehtësojë tregëtinë duke ofruar burime financiare dhe ndërtim kapacitetesh për SME-të e orientuara drejt eksportit.
- **Promovimi i qëndrueshmërisë së ndërmarrjeve publike nëpërmjet komercializimit dhe pjesëmarrjes së sektorit privat:** Shqipëria haset me sfida të mëdha për vendosjen e dispozitave të shërbimeve bashkiake dhe të energjisë në bazë të qëndrueshme. Në përputhje me rrethanat, Banka do të eksplorojë mënyra për të mbështetur më mirë ristrukturimin e thellë të sektorit energjetik, të udhëhequr nga Banka Botërore. Në varësi të progresit për zhvillimin e një mjedisi rregullator të favorshëm dhe të besueshëm, kjo mund të përfshijë ofrimin e financimit për prodhuesit privatë të pavaruar të energjisë nga burimet hidrike. Banka mund të angazhohet po ashtu në ristrukturimin e kompanive shtetërore të energjisë elektrike për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen, me kusht që të ketë një angazhim të besueshëm nga qeveria për komercializimin. Me ecjen përpara të reformës territoriale, Banka do të synojë të angazhohet në financimin e infrastrukturës bashkiake dhe mjedisore, duke e vënë theksin kryesisht tek transporti urban, ndriçimi i rrugëve dhe uji.

# 1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI AKTIVITETET E BANKËS

## 1.1 Portofoli aktual i Bankës

Deri më 30 nëntor 2015

Përqindja e investimeve të bankës në sektorin privat është 56% (te pese viteve te akumuluar, 2010-2015)

Grupi sektorial	Skuadra sektoriale	Portofoli nr. i operacioneve	Portofoli (€n)	% Portofoli	Asetet op.	% e aseteve op.
<b>Energjetika</b>	Burimet natyrore	3	103	21%	55	21%
	Energjia dhe energjitika	7	52	10%	41	15%
		<b>10</b>	<b>154</b>	<b>31%</b>	<b>96</b>	<b>36%</b>
<b>Institucionet financiare</b>	Kreditimi me depozita (bankar)	2	7	1%	7	3%
	Sigurimet, Pensionet, Fondet e Ndërsjella	0	0	0%	0	0%
	Finacimi me <i>leasing</i>	1	1	0%	1	0%
	Kreditimi jo me depozita (jo bankar)	9	109	22%	7	2%
		<b>12</b>	<b>117</b>	<b>24%</b>	<b>15</b>	<b>5%</b>
<b>Industria, Tregtia &amp; Agrobiznesi</b>	Agrobiznesi	1	0	0%	0	0%
	Fondet e kapitalit	6	22	4%	11	4%
	ICT	0	0	0%	0	0%
	Prodhimi & Shërbimet	3	15	3%	9	3%
	Pronat dhe turizmi	1	14	3%	14	5%
	<b>11</b>	<b>52</b>	<b>10%</b>	<b>35</b>	<b>13%</b>	
<b>Infrastruktura</b>	Infra. Bashkiake & Mjedisore	2	13	3%	7	3%
	Transporti	7	160	32%	115	43%
	<b>9</b>	<b>174</b>	<b>35%</b>	<b>122</b>	<b>46%</b>	
<b>Përmbledhje</b>		<b>42</b>	<b>497</b>	<b>100%</b>	<b>268</b>	<b>100%</b>

## 1.2 Zbatimi i drejtimeve strategjike të mëparshme

Strategjia aktuale për Shqipërinë është miratuar nga Bordi më 11 dhjetor 2012, me këto katër përparësitë kryesore strategjike:

- Promovimin e politikave të qëndrueshme të energjisë dhe investime të shëndosha në aspektin mjedisor.
- Rritjen e komercializimit, konkurrencës dhe përfshirjes së sektorit privat në infrastrukturë, përgjatë projekteve të synuara në sektorin publik.
- Mbështetjen e zhvillimit të një sektori privat më konkurrues .
- Forcimin e sektorit financiar dhe thellimin e ndërmjetësimit.

Zbatimi i Strategjisë për Shqipërinë ndodhi gjatë një periudhe të vështirë për Shqipërinë. Në aspektin politik, kalimi i pushteteve u realizua në mënyrë paqësore. Megjithatë, pas zgjedhjeve dolën në pah shuma të mëdha pagesash të prapambetura nga shteti dhe ndërmarrjet shtetërore, të cilat duheshin paguar. Xhiroja e madhe e stafit në administratë paraqiti sfida operative për investitorët, përfshirë dhe BERZH-in. Mjedisi ekonomik karakterizohet nga rritja dhe investimet e ulëta për shkak si të faktorëve të brendshëm dhe kontraktimit të Italisë dhe Greqisë, partnerët kryesorë të tregtisë dhe investimeve për Shqipërinë.

Zhvillimet në **sektorin energjetik** kanë qenë veçanërisht sfiduese. Pas shitjes së 76 përqind të kompanisë shtetërore të shpërndarjes CEZ-it në vitin 2009, autoritetet e revokuan licencën e kompanisë çeke në janar të vitit 2013, duke i hedhur fajin CEZ-it për gjendjen e rëndë të mungesave në energji elektrike në disa rajone. Kostot e larta të importit të energjisë elektrike dhe çmimet e ulëta të rregulluara brenda vendit, së bashku me humbjet e shpërndarjeve dhe me të ardhurat e pambledhura e kishin detyruar CEZ-in të operonte me humbje, duke e detyruar kompaninë të ndërpriste energjinë elektrike deri sa të paguheshin faturat e prapambetura. Si pasojë e kësaj situatë, u anulua programi i Bankës për përmirësimin e efikasitetit në shpërndarjen e energjisë elektrike. Gjatë periudhës së kësaj strategjie, Banka ka vijuar të punojë me Bankën Botërore, SECO-n dhe KfW-në për të mbështetur financimin e investimeve për rritjen e sigurtisë në digën e hidrocentralit të Komanit – pjesë e impiantit më të madh për prodhimin e energjisë elektrike në Shqipëri.

Në **sektorin e burimeve natyrore**, rindërmjetësimi mjedisor dhe zhvillimi i fushave të naftës së Patos-Marinzës i ka arritur objektivat e tij, duke i përmbushur nivelet e produktit dhe duke rritur rolin e sektorit privat, si dhe duke rritur në mënyrë të ndjeshme standardet mjedisore dhe sociale në sektor. Banka e ka ndihmuar po ashtu Ministrinë e Energjetikës dhe Industrisë nëpërmjet një projekti Bashkepunimi Teknik (TC) duke prezantuar një sistem për menaxhimin e informacionit për monitorimin e koncesioneve në sektorët e minierave dhe të hidrocentraleve.

Në **sektorin e transportit**, rehabilitimi i projektit të rrugëve lokale dhe rajonale ka vijuar në mënyrë shumë të suksesshme, duke e rritur pjesëmarrjen e sektorit privat dhe standardet teknike. Ndërtimi i Bajpasit të Fierit dhe Vlorës ka pasur zhvillim të mirë, pavarësisht disa vonesave të shkaktuara nga procedurat e brendshme të qeverisë. Këto projekte e kombinojnë financimin e huave me fondet e grantit dhe kanë shërbyer si shembuj të mirë të koordinimit të suksesshëm të donatorëve ndërmjet Bankës, KE-së dhe BEI-t përmes Kuadrit të Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF). Gjithashtu, Banka ka filluar projekte të Bashkëpunimit Teknik për të mbështetur reformën në sektor dhe forcimin institucional, si për shembull, strategjinë për vendosjen e tarifave për përdorimin e rrugëve, një studim-plan për transportin e qëndrueshëm, një projektim të detajuar për rehabilitimin e linjës hekurudhore Durrës-Tiranë, si dhe vlerësimin financiar dhe ekonomik të të gjithë rrjetit shqiptar të hekurudhave.

**Sektori i korporatave** është hasur me një mjedis veçanërisht të vështirë gjatë tre viteve të fundit dhe shumë biznese i kanë anuluar ose shtyrë planet e tyre të investimeve. Në fillim të vitit 2015, Banka nxorri me sukses investimin e saj nga *Antea Cement*, një projekt që ka shërbyer për rritjen e konkurrencës në industrinë e çimentos. Banka nënshkroi një transaksion të suksesshëm nëpërmjet produktit të Instrumentit të Ndarjes së Riskut (ish Linja për Bashkëfinancimin e Ndërmarrjeve të Mesme), i cili sjell standarde të reja për industrinë përpunuese të ferrokromit.

Gjithashtu, Programi për **Mbështetjen për Biznesin e Vogël i Bankës** është rritur. Vetëm në vitin 2014, Banka ka filluar 67 projekte këshillimore, nga të cilat 61 kanë qenë me konsulentë lokalë që janë përqendruar kryesisht në marketing, Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (ICT), strategji dhe menaxhim cilësie, dhe 6 me këshilltarë ndërkombëtarë të fokusuar në përmirësimin e operacioneve, eksportet dhe planifikimin strategjik. Në vitin 2014, MSME-të që përfitonin nga shërbimet këshillimore të Bankës kanë rritur mesatarisht xhiron me 13 përqind, produktivitetin me 8 përqind dhe kanë hapur 530 vende pune.

Gjatë periudhës së strategjisë, **sektori financiar** është ndikuar nga huadhënia e dobët financiare në kushtet e kërkesës së madhe dhe nivelit shumë të lartë të huave të këqija (22.8 përqind në fund të 2014-ës). Banka ka vijuar të angazhohet me sektorin financiar, si për të mbështetur SME-të nëpërmjet huadhënies dhe për të forcuar më tej qëndrueshmërinë financiare. Për këtë qëllim ajo ka planifikuar dhe disbursuar tri linja për SME-të tek dy banka lokale dhe një kompani leasing, duke siguruar linja financimi tregtare për një banke lokale dhe duke mbështetur një kompani leasing dhe dy institucione mikro-finance me linja kreditimi sipas nevojës. Për më tepër, Banka ka kontribuar në mënyrë të rëndësishme në forcimin e stabilitetit të sistemit financiar duke siguruar një linjë garancie prej 100 milionë EUR për Agjencinë e Sigurimit të Depozitave në Shqipëri (ASD). Gjithashtu, ASD është ndihmuar me një projekt të plote Bashkepunimi Teknik (TC) që synon të zhvillojë procedurat e brendshme përmes një sistemi automatik pagesash për depozituesit, duke mundësuar pagesa të menjëhershme dhe të rregullta në rast të likuidimit ose shpërbërjes së një banke. Për më tepër, Banka ka financuar një Instrument për Pjesëmarrjen në Ndarjen e Riskut me Bankën Intesa Sanpaolo në Shqipëri, me nënluanë e parë në sektorin e sipërpërmendur të perpunimit të ferrokromit. Ndarja e riskut të pafinancuar i përshtatet mirë me tregun shqiptar me likuiditet të lartë, pasi u ofron bankave partnere një mënyrë për të menaxhuar kapitalin dhe përqendrimit e riskut, teksa përdorin burimet e tyre të bollshme. Banka ka qenë po ashtu pjesëmarrëse aktive në dialogun ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe bankave tregtare për forcimin e procedurave të zbatimit për ekzekutimin e kolateralit dhe trajtimin e çështjeve të huave të këqija. Banka ka mbështetur përpjekjet për koordinimin rregullator të Bankës së Shqipërisë me autoritetet vendase duke përdorur platformën e koordinimit të Iniciativës së Vjenës, ku Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ka përfaqësuar të gjithë rajonin e EJK-së deri në vitin 2014. Për më tepër, si pjesë e Iniciativës së BERZH-it për Monedhën Lokale dhe Tregun Kapital Lokal, Banka ka kryer një vlerësim fillestar të gjendjes aktuale të tregjeve kapitale të Shqipërisë dhe ka ndarë me autoritetet rekomandimet e saj lidhur me mënyrën sesi të zgjerohet zhvillimi i tregjeve kapitale në vend.

Së fundi, Banka ka ruajtur një angazhim të nivelit të lartë me Qeverinë për përmirësimin e **mjedisit të biznesit** dhe luftën kundër korrupsionit. Shqipëria është përzgjedhur si vend pilot për Nismen për Klimën e Investimeve dhe Qeverisjen (ICGI). Në shkurt të 2014-ës u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, dhe Presidentit të Bankës, ku u detajuan masa dhe përgjegjësi për zbatimin e nismës. Projekti i parë në kuadrin e ICGI-së në Shqipëri ka qenë krijimi i Këshillit të Investimeve me një sekretariat profesional të financuar nga donatorët për lehtësimin e dialogut sistematik të reformave ndërmjet qeverisë dhe sektorit privat. Gjithashtu Banka ka bashkepunuar me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri për ndërtimin e kapaciteteve për qeverisjen e mirë të Shkolles Shqiptare për Administrimin Publik, krijimin e një kodi drejtues për bizneset dhe rritjen e rolit të shoqërisë civile mbi qeverisjen publike dhe të korporatave në bashkepunim me Koordinatorin Kombëtar për Anti-Korrupsionin.

### 1.3 Mësimet kyçe të nxjerra

Sektori jo funksional i shpërndarjes me energji elektrike e ka cenuar rëndë të gjithë **sektorin energjetik** dhe ka pasur ndikim negativ mbi investimet aktuale të Bankës, si dhe mbi aftësinë e saj për të nisur projekte të reja të financuara nga banka në këtë sektor. Humbjet teknike kanë arritur deri në 40 përqind dhe vjedhjet e energjisë, megjithëse me tendencë në rënie, kanë vijuar të jenë të shpërndara gjerësisht. Disiplina e pagimit ka qenë e dobët ndërmjet konsumatorëve privatë, biznesit dhe madje dhe qeverisë, ndërsa kompania shtetërore e prodhimit të energjisë elektrike, KESH, kishte akumuluar pagesa të mëdha të prapambetura

ndaj prodhuesve të pavarur të energjisë elektrike. Kjo situatë ka pasur ndikim mbi hidrocentralet e vogla të financuara nga Banka nëpërmjet Linjes së të Financimit të Drejtpërdrejtë për Energji të Qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor (WeBSEDF), të cilat përndryshe do të kishin përfunduar me sukses. Banka Botërore po drejton aktualisht një Projekt për Rimëkëmbjen e Energjisë, ndërsa që prej fundit të vitit 2014 qeveria ka filluar t'i trajtojë me rigorozitet çështjet e faturave të papaguara dhe vjedhjes së energjisë elektrike. Këto zhvillime pozitive mund të hapin rrugën për riangazhimin e Bankës në sektorin e energjisë elektrike.

Fragmentimi i bashkive dhe mungesa e autonomisë fiskale e kanë ndaluar shumë Bankën të angazhohet në **sektorin infrastrukturor bashkiak**. Megjithatë, kjo situatë mund të ndryshojë në periudhën e strategjisë së radhës, pasi qeveria po zbaton një reformë territoriale me vizion, me mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar. Deri sa të ndodhin këto ndryshime, aftësia e Bankës për të financuar projektet bashkiake do të jetë funksion i marrëveshjes politike ndërmjet klientëve të bashkisë dhe qeverisë qendrore (siç është demonstruar nga projekti PPP i terminalit të transportit publik në Tiranë).

Banka nuk ka qenë në gjendje të angazhohet në **sektorin e agrobiznesit**, kryesisht për shkak të fragmentimit të lartë në sektor. Ndërsa mund të ketë mundësi për financime të drejtpërdrejta në të ardhmen (p.sh. në shitjen me pakicë ,ose përpunimin ushqimor) ku sektori mund të ketë po ashtu nevojë për një qasje financimi të tërthortë (p.sh., Linje Mbështetje Agrobiznesi nëpërmjet bankave tregtare, mbështetur nga bashkëpunimi teknik (TC) për ndërtimin e kapaciteteve dhe mbulimin e humbjes së parë), si dhe mund të ofrojë shërbime këshillimore të përqendruara në bujqësi (p.sh., eksport, përmirësim operacionesh, menaxhim cilësie).

Së fundmi, në **sektorin bankar**, likuiditeti i lartë (56 përqind hua në raport me nivelin e depozitave) ka të ngjarë të vijojë të kufizojë kërkesën për produktet e financuara nga Banka gjatë periudhës së ardhshme strategjike. Për pasojë, ekziston nevoja për të zhvilluar produkte duke u përqendruar tek ofrimi i kapitalit çlirues për bankat (p.sh., ndarja e riskut në bazë projekti/portofoli) dhe linja kreditimi të dedikuara që trajtojnë segmente me shërbim më të ulët seç duhet (p.sh., gratë në biznes, bujqësia, eficaenca energjetike).

Banka do të përpiqet të rrisë numrin e transaksioneve me sektorin privat, e kontraktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nëpërmjet Institucioneve Ndërkombëtare Financiare.

## 2 MJEDISI OPERACIONAL

### 2.1 Kuadri politik

Zgjedhjet e përgjithshme në vitin 2013 shënuan kthimin në pushtet të Partisë Socialiste të qendrës së majtë (PS), e udhëhequr nga lideri i saj, Edi Rama, pas tetë vitesh në opozitë. Qeveria aktuale me Ramën si Kryeministër u krijua më 15 shtator 2013. Qeveria e drejtuar nga PS-ja përfshin si partner të ri në koalicion një parti më të vogël të qendrës së majtë, LSI-në. Së bashku ata kanë një shumicë të sigurt në parlament. Zgjedhjet e ardhshme parlamentare planifikohen në verën e 2017-ës. Zgjedhjet lokale, të organizuara në qershor të 2015-ës, përfunduan me pjesën më të madhe të bashkive, përfshirë dhe Tiranën, të fituara nga koalicioni qeveritar. Në kryeqytet, ku bashkëpunimi ndërmjet qeverisjes qendrore dhe



organeve vendore në të shkuarën është penguar shpesh nga lufta e brendshme politike, kjo situatë mund të krijojë kushte më të favorshme për projektet që kërkojnë këtë bashkëpunim.

Kryeministri Rama ka prezantuar një program modernizimi të mbështetur nga reforma e qeverisjes, forcimi i shtetit të së drejtës dhe lufta kundër korrupsionit në politikën e brendshme, dhe me përsheptimin e afimit me BE-në si përparësia kryesore e vendit në fushën e politikës së jashtme. Lidershipi shqiptar e ka kuptuar tashmë se pa përmirësimin e mjedisit të biznesit do të jetë e vështirë të tërhiqen investimet e huaja dhe të realizohet rritja e qëndrueshme. Kjo është gjithashtu dhe një kërkesë e shprehur e BE-së.

Perspektiva për progres të mëtejshëm në rrugën drejt BE-së mbetet spiranca kryesore për implementimin e reformave. Vullneti politik i demonstruar nga autoritetet e reja shqiptare dhe hapat fillestarë praktikë në zbatimin e reformave janë shpërblyer nga afimi i përsheptuar i vendit me BE-në. Shqipëria e mori zyrtarisht statusin e vendit kandidat për në BE në qershor të 2014-ës. Megjithatë, mbeten ende sfida të mëdha. Sipas përfundimeve të Raportit të fundit të Progresit të Komisionit Evropian (KE) për Shqipërinë, vendi duhet të vazhdojë me një reforme gjithëpërfshirëse në sistemin gjyqësor dhe përmirësimin e mjedisit të biznesit si dhe të përmirësojë kulturën e dialogut politik ndërmjet qeverisë dhe opozitës. Opozita, e cila ka 35 përqind të vendeve në parlament, e bojkotoi parlamentin për pjesën më të madhe të vitit 2014. Marrëdhëniet kanë mbetur të tensionuara, megjithë rikthimin e saj në parlament në fund të 2014-ës, duke penguar funksionimin normal të organit legjislativ.

Autoritetet kanë nisur së fundmi një reformë për vetëqeverisjen vendore, e projektuar për të thjeshtuar organizimin territorial të vendit, trajtuar pabarazitë ekzistuese ndërmjet rajonave dhe rritur eficientën dhe cilësinë e përgjithshme të shërbimeve ndaj qytetarëve. Masat e para përfshijnë harmonizimin e njësive ekzistuese të vetëqeverisjes vendore duke i shtrirë më shumë sesa 300 njësi të tilla në 61 bashki. Megjithëse reforma gjithëpërfshirëse mund të kërkojë kohë, veçanërisht lidhur me rritjen e kapaciteteve në nivelin bashkiak dhe transferimin e kompetencave të caktuara nga qeveria qendrore tek qeveritë vendore, progresi në këtë rrugë mund të jetë i përshtatshëm për një angazhim më të madh të institucioneve ndërkombëtare financiare në nivelin lokal.

Shih Shtojcën 1 për një vlerësim të detajuar politik në kuadrin e nenit 1.

## 2.2 Kuadri makroekonomik

**Performanca ekonomike ka qenë e ngadaltë që prej vitit 2012.** Shqipëria, ndryshe nga pjesa më e madhe e ekonomive në rajonin e EJT-së, ka regjistruar nivele pozitive rritjeje gjatë të gjithë krizës globale dhe të Eurozonës në vitet e fundit, por ritmi i rritjes është ngadalësuar ndjeshëm vitet e fundit. Aktiviteti ekonomik nga ndërtimi ka rënë në mënyrë të ndjeshme, pasuar edhe nga ai i prodhimit. Kjo ndikoi si në problemet e brendshme, përkatësisht pagesat e prapambetura të qeverisë drejt biznesit, reduktimin e lehte të portofolit të huave, rritjen negative të kreditimit në bazë vjetore për sektorin privat dhe nivelin e lartë të huave të këqija, si dhe vështirësi në partnerët më të rëndësishëm ekonomikë të Shqipërisë, Italinë dhe Greqinë. Vlerësimet paraprake për 2014-ën tregojnë për një rritje prej 1.9 përqind, me shërbimet, veçanërisht tregtinë, hotelet dhe restorantet si kontribuesit më të mëdhenj të rritjes. Kërkesa agregate e dobët dherritja e çmimeve të importit, si dhe rënia e çmimeve të naftës, e kanë mbajtur inflacionin nën objektivin prej 2-4 përqind të Bankës Qendrore. Në përputhje me nivelin në ulje të infacionit (prej vetëm 1.6 përqind në vitin 2014), Banka Qendrore ka zbatuar një politikëmonetare ekspansioniste me anë të disa shkurtimeve në nivelin bazë të

interesit, me shkurtimin më të fundit në janar të 2015-ës, duke e ulur interesin në një nivel të ulët historik prej 2 përqind. Kombinimi i inflacionit të ulët, nivelit të rehatshëm të rezervave dhe mbështetjes së FMN-së ka ndihmuar në stabilitetin e kohëve të fundit të kursit të këmbimit LEK/EUR.

**Konsolidimi fiskal ka përparuar.** Të ardhurat në vitin 2014 janë rritur, duke reflektuar përmirësimin e mbledhjes së TVSH-së dhe rritjen e tatimit të të ardhurave të korporatave nga 10 në 15 përqind. Në aspektin e shpenzimeve, qeveria ka realizuar kursime në shpenzime, përfshirë shpenzimet për personelin dhe shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes. Shpenzimet e interesit për borxhin publik janë më të ulëta, si pasojë e normave më të ulëta të interesit. Në përgjithësi, deficiti i vitit të fundit ishte vetëm pak më i lartë se ai në vitin 2013, megjithë që buxhetit ju desh të përballonte shlyerjen e një pjesë të madhe të pagesave të prapambetura të qeverisë për bizneset. Pas një deficiti fiskal prej më shumë se 5 përqind të PBB-së gjatë dy viteve të fundit, raporti i borxhit publik me PBB-në ka arritur më shumë 70 përqind të PBB-së, nivel i cili është i lartë sipas standardeve rajonale, por ka shenja që piku mund të jetë arritur në vitin 2014 dhe që raporti do të fillojë të ulet deri në fund të vitit 2015. Marrëveshja tre-vjeçare e FMN-se mbi Instrumentin e Zgjeruar të Fondit (EFF) prej 331 milionë euro është në rrugën e duhur, megjithëse përfundimi i rishikimit të pestë është vonuar. Programi i FMN-së, i nënshkruar në shkurt të 2014-ës, është plotësuar edhe nga dy hua për politikën zhvillimore nga Banka Botërore, në total 220 milionë dollarë amerikanë, të cilat synojnë të forcojnë menaxhimin e financave publike dhe stabilitetin e sektorit financiar. Me këto fonde, qeveria ka paguar pjesën më të madhe të faturave të prapambetura për kompanitë të cilat vlerësohen të kishin arritur në rreth 500 milionë euro, ose 5.4 përqind të PBB-së. Ky injektim likuiditeti në ekonomi është pa dyshim zhvillim pozitiv për sektorin bankar, pasi faturat e papaguara nga qeveria kanë kontribuar në të shkuarën në rritjen e problemit të huave të këqija.

**Në kuadrin afatshkurtër, rritja parashikohet të rimëkëmbet, por të mbetet e moderuar, me risk domethënës për rënie.** Rritja ka të ngjarë të rimëkëmbet në vitin 2015 me 2.5 përqind dhe me një rritje vjetore nga 3-4 përqind në periudhën 2016-18, ndihmuar nga shlyerja e pjesës më të madhe të pagesave të prapambetura nga qeveria, politikën monetare mbështetëse (norma më të ulëta të interesit) dhe një rimëkëmbje graduale për kredidhënien bankare, si me fillimin e punimeve në Gazsjellësin Trans-Adriatik (TAP). Në kuadrin afatmesëm, Shqipëria mund të përfitojë ndjeshëm nga një rimëkëmbje e Eurozonës, nëse është në gjendje të bëjë progres të mëtijshëm mbi reformat strukturore dhe të përparojë drejt çeljes së negociatave për praninë në BE. Progresi drejt anëtarësimit në BE dhe aderimi në politika të shëndosha makroekonomike, kombinuar me përmirësimet e dukshme në mjedisin e biznesit, përfshirë dhe përmirësimin e efikasitetit të administratës, një sistem më të pavarur gjyqësor dhe më pak korrupsion, do ta bëjnë vendin më tërheqës për investimet e huaja potenciale.

**Risqet për rënie janë të larta.** Ekonomia ende ka deficite të dyfishta domethënëse (fiskale dhe të llogarive korrente), dhe sektori financiar vijon të jetë i ekspozuar ndaj rreziqeve të brendshme dhe të jashtme, përfshirë dhe nivelin e lartë të huave të këqija. Për më tepër, lidhjet e ngushta ekonomike me Greqinë dhe Italinë nënkuptojnë rreziqe, veçanërisht në kuadrin e rritjes së pasigurisë lidhur me ekonominë greke. Eksportet drejt Italisë zënë rreth 50 përqind të totalit të eksporteve, ndërsa të dyja shtetet janë destinacione të rëndësishme për punonjësit migrantë shqiptarë, dhe për pasojë, burim kryesor i remitancave shqiptare. Lidhjet kryesore me Greqinë janë në sektorin financiar, me filiale të bankave greke që ruajnë një përqindje të konsiderueshme (megjithëse në rënie) të tregut të sektorit bankar në Shqipëri.

Këto banka nuk mbështeten më tek financimi nga bankat mëmë, megjithatë nuk mund të përjashtohen efektet negative për shkak të krizës bankare në Greqi. Nje renie ne klimen e biznesit, veçanerisht kushtet e investitoreve te huaj mund te ndikojne ne uljen e IHD (Investimeve te Huaja Direkte) ne te ardhment, mbi te cilat Shqipëria do vazhdoje te jete e varur per te financuar deficitet e llogarive aktuale. Niveli i lartë i borxhit publik është një tjetër burim shqetësimi, i cili kufizon rëndë hapësirën fiskale për pjesën më të madhe të projekteve për shpenzime publike.

### 2.3 Konteksti i reformës strukturore

Pavarësisht 25 viteve progresi në tranzicion, Shqipëria haset ende me një program reformash të rëndësishme, përgjithësisht të orientuara drejt objektivit për anëtarësim në BE. Qeveria shqiptare i ka vendosur reformat për mjedisin e biznesit dhe klimën e investimeve në zemër të programit të saj ekonomik. Qeveria po vijon po ashtu me përpjekjet për të privatizuar pjesët e mbetura të kapitalit në kompanitë e mëdha, duke përfshirë dhe 16.8 përqindëshin e saj në Albtelecom. Megjithatë, oreksi i investitorëve aktualisht është i paqartë.

Gjatë vitit 2014 dhe 2015 ka pasur zhvillime pozitive edhe në sektorin e energjisë elektrike. Qeveria ka zgjidhur një mosmarrëveshje të madhe me ndërmarrjen çeke të energjisë CEZ dhe ka rënë dakord për një hua me Bankën Botërore në shumën prej 150 milionë dollarësh amerikanë për të mbështetur rimëkëmbjen dhe reformat e sektorit energjetik në vend. Po ashtu, Parlamenti ka miratuar një ligj të ri për energjinë elektrike në përputhje me Paketën e Tretë Energjetike, i cili është mirëpritur nga Komuniteti i Energjisë. Rëndësia e ligjit shkon përtej përputhshmërisë formale me legjislacionin e BE-së, pasi përbën një hap vendimtar drejt rrugës së gjatë të reformave energjetike në Shqipëri, për të cilat ai krijon një bazë solide. Qeveria ka ndërmarrë po ashtu përpjekje të fokusuara në uljen e borxhit të keq dhe vjedhjeve të energjisë elektrike, të cilat kanë përmirësuar ndjeshëm likuiditetin dhe autonominë e sektorit në gjysmën e parë të vitit 2015.

Deri në ditët e sotme ,nuk ka pasur treg gazi në Shqipëri, por planet për krijimin e një tregu funksional gazi gjatë viteve të ardhshme si rezultat i ndërtimit të Gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP) po përparojnë. TAP ka për synim të transportojë gaz nga Azerbajxhani në Itali, me një degë të propozuar të Gazsjellësit Adriatiko-Jonian (IAP) nga Shqipëria në Kroaci. Masterplani afatmesëm gjithëpërfshirës për gazin natyror, i prezantuar nga qeveria, mbështetur financiarisht nga BE-ja dhe drejtuar nga BERZH-i, do të shqyrtojë të gjitha aspektet (teknike, ligjore, rregullatore, ekonomike, të tregut dhe sociale) të lidhura me prezantimin e sistemit të gazit në vend.

### 2.4 Mjedisi i biznesit dhe kuadri ligjor

#### *Mjedisi i biznesit*

Përpjekjet për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe klimës së investimeve në vend janë në zhvillim. Në të njëjtën kohë, të dhënat nga sondazhet e kohëve të fundit, përfshirë dhe Sondazhin e Performancës së Mjedisit të Biznesit dhe Ndërmarrjeve të BERZH-it/Bankës Botërore (BEEPS), theksojnë vështirësitë e vazhdueshme për bizneset lidhur me konkurrencën e padrejtë nga sektori i madh informal dhe korrupsioni – të gjitha çështje të cilat vijnë si rezultat i dështimeve më të gjera qeveritare si dhe fenomene të rrënjësura që janë në krye të përpjekjeve të qeverisë aktuale për reforma.

Nisma e Bankës për Klimën e Investimeve dhe Qeverisjes në Shqipëri ka rezultuar në një numër ndërhyrjesh të përqendruara për të ndihmuar në adresimin e disa prej këtyre çështjeve. Nëpërmjet Këshillit të Investimeve të krijuar së fundmi, të kryesuar nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik dhe i koordinuar nga një sekretariat profesional i financuar nga donatorët, bizneset kanë identifikuar disa pengesa me të cilat hasen dhe që duhet të trajtohen nga qeveria, përfshirë dhe nevojën për reformimin e sistemit të inspektimit të taksave, thjeshtim të procedurave të falimentit dhe forcimit të mekanizmave të zbatimit të kontratave.

### *Kuadri ligjor*

Sistemi ligjor ka qenë objekt reformash të vazhdueshme gjatë viteve të fundit. Forca kryesore shtytëse për këto reforma ka qenë procesi i integritimit në BE. Megjithatë, ka shumë fusha ku nevojiten reforma të mëtejshme të thelluara:

- Në përgjithësi, nevojitet progres për reformat që trajtojnë paqartësitë lidhur me çështjet e pronësisë, mangësitë në kuadrin rregullator dhe dobësitë në zbatimin e kontratave, të cilat vijojnë të jenë të dëmshme për mjedisin e biznesit. Ritmi i legalizimit të pronave, kthimit dhe kompensimit mbetet ende i ngadaltë.
- Në fushën e të drejtës së shoqërive tregtare, janë miratuar ndryshimet në "Ligjin për Sipërmarrjet dhe Shoqëritë Tregtare" të 2008-ës, përfshirë dispozitat që kanë të bëjnë me kërkesat për raportim dhe dokumentacion për shkrirjet dhe ndarjet e shoqërive. Megjithatë, është me rëndësi thelbësore që ligji për shoqëritë tregtare të mbetet në përputhje me ligjet e tjera, pavarësisht rishikimeve të herë pas hershme. Në fushën e kontabilitetit të kompanive të mëdha, janë miratuar po ashtu dhe standardet e reja kombëtare të kontabilitetit në janar të 2015-ës. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit i ka vijuar përpjekjet për të rritur kapacitetin dhe ka miratuar një manual procedurash operative dhe metodologjish për transpozimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit në nivel kombëtar. Shqipëria duhet të përqendrohet tek zbatimi i standardeve të kontabilitetit dhe të auditimit dhe të rrisë më tej kapacitetin e vet të inspektimit si pjesë e punës për ndërtimin e një qeverisje të shëndetshme ekonomike. Legjislacioni duhet të jetë në përputhje më tej me *acquis*-in, veçanërisht lidhur me auditimin.
- Në fushën e gjyqësorit, Shqipëria ka dëshmuar angazhimin e saj për reforma, dukshëm duke u ndërvepruar me Komisionin e Venecias për të përmirësuar pavarësinë, përgjegjësinë dhe profesionalizmin e sistemit. Janë marrë masa për rritjen e përgjegjësisë së gjyqtarëve, prokurorëve, deputetëve dhe zyrtarëve të tjerë të lartë nëpërmjet miratimit të një ligji që rregullon çështjen e imunitetit. Ka pasur progres në krijimin e gjykatave administrative, të cilat kanë filluar nga puna në vitin 2014. Funksionimi i sistemit gjyqësor vazhdon të ndikohet nga politizimi, përgjegjësia e kufizuar, bashkëpunimi i dobët ndërinstytucional, burimet e pamjaftueshme dhe çështjet e prapambetura. Shqipëria duhet të ndjekë fuqimisht reformën gjyqësore me bashkëpunimin e të gjithë aktorëve.

Shih Shtojcën 4 për një vlerësim të detajuar të mjedisit ligjor në fusha specifike përkatëse që lidhen me strategjinë e Bankës.

## **2.5 Aksesi në financa**

### *Burimet private të kapitalit*

Sektori financiar ka mbetur stabël përgjatë të gjithë turbulencës së viteve të fundit, por rritja e kreditimit është e dobët, pasi ka qenë negative në bazë vjetore për rreth një vit (ndërmjet korrikut të 2013-ës dhe qershorit të 2014-ës), dhe institucionet financiare jo bankare janë

ende në fazat e para të zhvillimit. Asetet e sektorit bankar zënë 93 përqind të sistemit të përgjithshëm financiar me 16 banka që operojnë në sistem, prej të cilave 14 janë banka të huaja. Niveli i huave të këqija mbetet shumë i lartë, edhe sipas standarteve rajonale. Situata po lehtësohet në mënyrë progresive nëpërmjet shlyerjes graduale të pagesave të sektorit publik, paralelisht me ndryshimet legjislative në kodin civil për përmirësimin e ekzekutimit të kolateralit dhe ligjin për tatimin për fshirjen e huave bankare.. Në këtë kuadër, raporti i huave të këqija është ulur nga niveli i lartë prej 24.9 përqind në tremujorin e tretë të 2014-ën në 20.0 përqind në qershor 2015. Pavarësisht nivelit të lartë të huave të këqija, sektori bankar ka një raport relativisht të lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit me 16.0 përqind në qershor të 2015-ës.

Institucionet financiare jo bankare zënë një përqindje të vogël të sistemit financiar shqiptar, duke e përkeqësuar më tej aksesin e sektorit privat në financime, në veçanti SME-të. Në fund të vitit 2013, hyrjet nga leasingu qëndruan në nivelin e vetëm 1 përqind të PBB-së, megjithëse kuadri për sektorin e leasingut është krijuar, dhe rregullatori është aktiv në monitorimin e tregut. Tregu i sigurimeve mbetet i nënzhvilluar: me nivelin 0.6 përqind në fund të 2013-ës, raporti i primeve të sigurimeve /PBB-në vijon të mbetet konsiderueshëm nën të njëjtit raport në vendet e tjera të EJT-së. Ndërsa ligji i fundit për sigurimet ka forcuar mjedisin ligjor dhe rregullator, zbatimi efektiv mbetet ende sfidë. Do të mirëpritëshin përmirësime të tjera në fushën e kontabilitetit, standardeve të deklarimit dhe auditimit.

Tregjet kapitale mbeten të nënzhvilluara. Nuk ka realisht një treg burse. Megjithëse në Shqipëri ka kompani të cilat mund të kualifikohen për t'u listuar në bursë, kultura e ekonomisë informale dhe mungesa e transparencës i kanë parandaluar ofertat publike nga mundësitë e shqyrtimit si financim alternativ. Si rezultat i mospasjes së kompanive të listuara në Bursën e Tiranës (TSE), bursa u mbyll në fillim të vitit 2015. Përpos kësaj, ka një aktivitet shumë të kufizuar në tregun e bonovepërveç instrumenteve të borxhit qeveritar. Ka vetëm pak emetues të mëdhenj që janë të gatshëm të përmbushin standardet e larta të deklarimit dhe transparencës së biznesit. Përveç kësaj, duke pasur akses në financim të besueshëm dhe kosto efektive nga depozitat, pjesa më e madhe e bankave nuk kanë stimuj të fillojnë emetimin e bonove në tregun lokal. Krahas numrit të kufizuar të bonove të emetuara, pjesa më e madhe e tyre janë të disponueshme vetëm për pak investitorë privatë (p.sh., depozituesit e favorizuar të emetuesit, ose investitorë të pasur) pa një mekanizëm konkurrues tenderimi. Një treg i shëndetshëm bonosh për korporatat është i nevojshëm për të ofruar një burim të qëndrueshëm të financimit me afat për bankat lokale dhe veçanërisht për institucionet e mikrofinancës. Për kthimin e besueshmërisë së bonove të korporatave si klasë aset me një strukturë të thjeshtë dhe transparente bonoje, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) duhet të mbështesë ofertat institucionale duke krijuar një kuadër të qartë rregullator për emetimin e bonove të korporatave që orientohen drejt investitorëve më të sofistikuar.

Për t'i trajtuar këto sfida, Banka është angazhuar në një dialog për politikën e reformës dhe ka ndarë me Ministrinë e Financave dhe me Bankën e Shqipërisë një raport fillestar vlerësimi për tregjet kapitale të Shqipërisë, ndër të tjera, me rekomandimet e mëposhtme: promovimin e përdorimit të monedhës vendase (MV) dhe reduktimin e vazhduar të euroizimit nëpërmjet masave rregullatore për bankat, përmirësimin të likuiditetit në tregun ndërbankar të parasë në monedhën vendase dhe zhvillimin e një indeksi të besueshëm të krahasimit të tregut të parasë për bankat, inkurajimit të emetimit të bonove në monedhën vendase ose nëpërmjet palëve të interesuara, të tilla si institucionet e mikrofinancës dhe bankat me kapital të brendshëm, ose potencialisht nga BERZH-i (në varësi të kërkesës për hua në LEK shqiptare dhe të disa ndryshimeve në regjimin ligjor dhe rregullator), ndërmarrjen e masave për të zhvilluar tregun

dytësor të instrumenteve të sigurimit të borxhit në monedhën vendase, përfshirë dhe reduktimin e shpeshtësisë së ankandëve të bonove qeveritare dhe rritjen e aktivitetit në transaksionet në tregun e instrumenteve monetare bilaterale të sigurta, zhvillimin e një strategjie afatmesme për rritjen e pjesëmarrjes së huaj në tregjet e bonove qeveritare në monedhën vendase, sigurimin që rregulloret që mbulojnë fondet e investimeve të lejojnë dallimin e nevojshëm ndërmjet investimeve në fonde dhe depozitave bankare përpara inkurajimit të futjes së më shumë fondeve në treg dhe, së fundmi, ofrimin e edukimit për investitorët për rreziqet potenciale që lidhen me investimet në fonde dhe qartësimin që këto fonde nuk mbulohen nga sigurimi i depozitës.

#### *Financimi<sup>1</sup> bankar shumëpalësh dhe dypalësh për zhvillim*

BE-ja, Institucionet Ndërkombëtare Financiare si dhe disa agjenci bilaterale janë shumë aktive në Shqipëri dhe përbëjnë një burim të rëndësishëm financimi si për projekte individuale dhe për buxhetin.

Si shtet kandidat për në BE, Shqipëria përfiton nga financime domethënëse nga BE-ja. Nën Instrumentin e Parapranimit (IPA II), Shqipërisë i janë dhënë për periudhën 2014-2020 649.4 milionë euro. Financimi do të ofrohet gjithnjë e më tepër në formën e mbështetjes buxhetore për një sërë sektorësh parësorë për të çuar përpara pranimin në BE, përfshirë demokracinë, qeverisjen, shtetin e së drejtës, mjedisin, transportin, konkurrueshmërinë, novacionin, arsimin, bujqësinë dhe bashkëpunimin rajonal. Gjithashtu, nëpërmjet fondeve IPA II, BE pritet të financojë 1 miliard Euro për investime me prioritet në projekte të infrastrukturës rajonale.

Në shkurt të 2014-ës, FMN-ja u kthye në Shqipëri me një Marrëveshje për një Instrument të Zgjeruar të Fondit (EFF). Ky fond, mbi 295 milionë SDR (330 milionë në kohën e miratimit) po i vihet në dispozicion qeverisë si mbështetje buxhetore përgjatë tri viteve dhe mbështet programin e reformave të qeverisë.

Nisma për reformë e qeverisë së re, së bashku me kthimin e FMN-së, kanë çuar po ashtu në një rritje domethënëse të angazhimit të Grupit të Bankës Botërore në Shqipëri. Ia vlen veçanërisht të theksohet huaja prej 150 milionë eurosh për mbështetje të Programit të Rimëkëmbjes Energjetike të qeverisë, një program për mirëmbajtjen e rrugëve rurale dhe garancisë së bazuar në politika prej mbi 200 milionë eurosh në mbështetje të huasë tregtare për qeverinë. Për më tepër, po përgatitet një hua e re për zhvillimin e politikave, e cila mbështet përmirësimet në klimën e biznesit në Shqipëri. IFC-ja financon investitorët e huaj, të tillë si industrinë e çimentos dhe të burimeve natyrore.

Aktivitetet e Bankës Evropiane të Investimeve (EIB) në Shqipëri përqendrohen në infrastrukturën etransportit, si rrugët dhe portet. EIB/EIF (Fondi Evropian i Investimeve) janë partnerë kyçë në disa fonde rajonale, të tilla si Fondi i Gjellbër për Rritje, Fondi Evropian për Evropën Juglindore dhe Fondi Evropian i Zgjerimit.

KfW-ja është e angazhuar shumë në sektorin energjetik, veçanërisht në transmetimin e energjisë dhe në sigurinë e digave. KfW-ja është po ashtu dhe agjencia kryesuese nësektorin e ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri, ku ka nevoja shumë të mëdha për investime.

<sup>1</sup> Ky seksion përqendrohet tek niveli i lartë i financimit, ndërsa donatorët e tjerë dhe aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve mbulohen nga Kreu 3.5 dhe Shtojca 6.

## 2.6 Kuadri social

Sipas Indeksit të Zhvillimit Njerëzor të UNDP-së të vitit 2014 (HDI), Shqipëria renditet në vendin e 95-të nga 187 shtete, gjë që është nën mesataren e rajonit për Evropën dhe Azinë Qendrore dhe ndërmjet vendeve të renditura më ulët në rajonin e Evropës Juglindore (EJL).

Shqipëria ka një ndër popullsitë më të reja në Evropë, me moshë mesatare 33 vjeç, dhe me 40 përqind të popullsisë nën moshën 25 vjeç. Megjithatë, mbi një e katërta e të rinjve nuk janë në kushte të punësimit, arsimimit ose trajnimit (NEET), gjë që është reflektim i mungesës së mundësive për punësim lokal. Papunësia tek të rinjtë mbetet e lartë me 28.7 përqind krahasuar me totalin e papunësisë në nivelin 18 përqind. Cilësia e arsimimit është ndjeshëm nën mesataren e BE-së dhe mbetet prapa të gjitha shteteve të tjera në rajon, gjë që është e qartë nga rezultatet e ulëta të performancës së studentëve në testin e PISA-s, si dhe në perceptimin e ulët të familjeve për cilësinë e arsimit. Grupet e pakicave, në veçanti komunitetet rome, përballen me sfida shtesë. Ndërsa 96 përqind e shqiptarëve e kanë përfunduar arsimin fillor dhe 80 përqind kanë përfunduar klasat e larta të arsimit 9-vjeçar, vetëm 43 përqind e fëmijëve romë (40 përqind vajza dhe 46 përqind djem) kanë arsim fillor të plotë dhe 21 përqind e të rinjve romë kanë mbaruar klasat e larta të 9-vjeçares (18 përqind gra dhe 23 përqind burra). Flukset migratore drejt vendeve të tjera të EJL-së dhe BE-së dhe efekti pasues i "largimit të trurit", janë sfida të rëndësishme, veçanërisht ndërmjet të rinjve. Sipas ILO-s, dhe siç konfirmohet dhe nga një studim rajonal i kohëve të fundit nga Friedrich Ebert Stiftung, më shumë se dy të tretat e të rinjve shqiptarë ushqejnë shpresa për migracion. Punësimi, statusi ekonomik dhe nivelet arsimore janë tri faktorët kryesorë që kanë ndikim mbi synimet migratore të rinisë shqiptare. Të rinjtë vetëm me arsim të nivelit bazë janë më të zellshëm që të migrojnë (55 përqind) sesa të rinjtë me diplomë universiteti (34 përqind). Remitancat vlerësohen nga Banka Botërore që përbëjnë 8.5 përqind të PBB-së së Shqipërisë.

Ka pabarazi rajonale ndërmjet rajoneve të veriut dhe atyre qendrore dhe jugore të vendit, , në veçanti lidhur me aksesin rajonal në infrastrukturë dhe furnizimin me shërbime, punësim formal dhe financime. Furnizimi me ujë është ende problem. Thuajse 25 përqind e popullsisë nuk ka akses në sistemet e furnizimit me ujë, kanë mbulim të ulët rrjeti dhe cilësi më të dobët lidhjesh në zonat rurale malore. Pabarazitë rurale të varfërisë dhe ato rajonale në tregun e punës reflektojnë një dilemë të dyfishtë lidhur me informalitetin. Sipas ILO-s, puna e padeklaruar mbetet dominuese në zonat rurale të Shqipërisë, ku bujqësia është burimi kryesor i punësimit. Kjo është kryesisht punë familjare e papaguar: sipas Bankës Botërore, 58 përqind e popullsisë shqiptare kanë qenë të punësuar në pozicione të tilla vulnerabël punësimi në vitin 2013. Migracioni rezultues i popullsisë rurale në zona urbane shton presion të konsiderueshëm mbi tregun urban të punës, ku ai kontribuon drejt rritjes së informalitetit. Së fundmi, vetëm 23.5 përqind e popullsisë rurale në Shqipëri (me moshë 15+) kanë llogari bankare në një institucion financiar krahasuar me 28.3 përqind të totalit të popullsisë.

Niveli i pjesëmarrjes së grave në tregun e punës mbetet i ulët në 44.0 përqind, krahasuar me 65.5 përqind të nivelit për burrat. Gratë nga komunitetet rome dhe egjiptiane përballen me pengesa dhe më të larta. Vetëm 15 përqind e grave rome dhe 13 përqind e grave egjiptiane janë të punësuar, ndërsa përkatësisht 58 përqind dhe 73 përqind e tyre janë të papuna dhe janë në kërkim aktiv për punë. Për më shumë informacion rreth situatës së barazisë gjinore në vend, shih Shtojcën 5.

## 2.7 Kuadri i eficientës energjetike dhe ndryshimeve klimaterike

Për të përmbushur kërkesat për energji, vendi mbështetet tërësisht tek hidrocentralet dhe tek importet, dhe për pasojë, mbështetet fort edhe tek kushtet hidrologjike. Shqipëria ka po ashtu burime të mira për energji diellore, të erës dhe biomasës, por këto burime mbeten shumë të nënzhvilluara. Megjithëse ndërprerjet e energjisë elektrike janë ulur në mënyrë domethënëse gjatë pak viteve të fundit, Shqipëria përjeton ende më shumë ndërpreje të energjisë sesa pjesa tjetër e vendeve të Evropës Juglindore. Miratimi i ligjit "Për energjinë e rinovueshme" në vitin 2013 dha sinjalin e angazhimit për të përmirësuar rregullimin e burimeve të rinovueshme të energjisë në vend (RES), por zbatimi i legjislacionit mbetet ende sfidë. Shqipëria, është në zhvillim të planit të parë kombëtar të masave për energjinë e rinovueshme. Shqipëria nuk e përmbushi afatin me datë 30 qershor 2013 për të përgatitur dhe dorëzuar tek Sekretariati i Komunitetit të Energjisë planin kombëtar të masave për energji të rinovueshme, dhe për pasojë u drejtua tek Këshilli Ministerial nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në maj të 2015-ës.

Parlamenti miratoi më 30 prill 2015 një ligj të ri për sektorin energjetik në përputhje me paketën e 3-të të BE-në për Tregun Energjetik, e cila do të diktojë sërish ndryshim në ligjin për energjinë e rinovueshme.

Intensiteti i karbonit i Shqipërisë është ende i lartë në krahasim me mesataren e 28 vendeve të BE-së (0.34 CO<sub>2</sub>/GDP kundrejt 0.24 për BE-në). Sektori rezidencial është përdoruesi fundor më i madh i energjisë dhe përbën thuajse gjysmën e konsumit të energjisë elektrike. Ndërtesat e sektorit publik janë shpesh jo eficiente, duke krijuar mundësitë për investime që do të shkurtonin kostot energjetike. Ligji "Për eficientën e Energjisë" është përgjithësisht në përputhje me *acquis*-in dhe është përgatitur me mbështetjen e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Plani i Parë për Eficencën Energjetike (EEAP) është miratuar në vitin 2011, duke përcaktuar një indeks kombëtar për objektivin e kursimit të energjisë prej 168 Ktoe deri në vitin 2018 (9 përqind).

Shqipëria ofron potenciale domethënëse teknike për kursimin e energjisë, disa prej të cilave mund të trajtohen përmes projekteve ESCO. Megjithatë, çështjet tregtare do të duhet ende të zhvillohen. Nganjëra anë, organet publike shpesh nuk kanë stimul të fortë dhe arsye komerciale për investimet me eficientë energjetike, ose për nisjen e projekteve të ESCO, pasi disiplina e pagimit të energjisë është e ulët, madje edhe në sektorin publik. Po ashtu, çmimet e ulëta të energjisë, mbështetja e dobët politike, dhe kuadri rregullator i paqartë mbeten ende pengesa. Rishikimi i ligjit "Për Eficencën Energjetike" është ende në proces e sipër. Plani i parë Kombëtar i Masave për Eficencën Energjetike (NEEAP) është botuar në vitin 2010 dhe NEEAP-i i dytë po hartohet me mbështetjen teknike të ofruar nga BERZH-i dhe në bashkëpunim të ngushtë me Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Kërkohet krijimi i një baze rregullatore dhe tregtare për eficientë energjetike për investime të mëtejshme të eficientës energjetike, përfshirë dhe projektet ESCO.

Në Komunikimin e 2-të Kombëtar të Shqipërisë në kuadrin e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) janë identifikuar disa përparësi adaptimemesh për ndryshimet klimatike të cilat janë të rëndësishme për t'u trajtuar gjatë dekadave në vijim. Për shembull, ndryshimet në reshje dhe në temperatura parashikohet të intensifikojnë presionin për burimet ujore. Përmirësimet në infrastrukturën ujore dhe në eficientë e përdorimit të ujit në bujqësi dhe në industri do të jetë përparësi kyçe. Prodhimi i hidrocentraleve parashikohet të ndikohet nga ndryshimet klimatike në hidrologji dhe uljet e ujit sipërfaqësor, të cilat duhet të merren parasysh për investime domethënëse. Së fundmi,



ndikimet në ngritjen e nivelit të detit dhe erozionit bregdetar do të duhet të merren parasysh në investimet në infrastrukturën bregdetare, të tilla si në porte. Rreziku më urgjent i ndryshimeve klimatike në Shqipëri është ekspozimi i sektorit energjetik ndaj kushteve të ndryshueshme dhe ekstreme të motit, veçanërisht ndaj thatësirave gjatë verës (të komplikuar me konfliktet me kërkesën për vaditje), të cilat çojnë në ndërprerje të rënda të energjisë elektrike dhe nevojën për eksporte të shtrenjta nga vendet fqinje, të tilla si Italia.

### 3 ORIENTIMET STRATEGJIKE

#### 3.1 Drejtimet strategjike

Shqipëria ka bërë progres gjatë viteve të fundit në krijimin e një kuadri të shëndoshë makro-ekonomik dhe në trajtimin e disa prej problemeve më thellë të rrënjësura me të cilat haset ekonomia. Vendi po përfiton nga një moment i ripërtërirë reformash, i synuar në veçanti për përmirësimin e mjedisit të përgjithshëm të biznesit, duke trajtuar sfidat në sektorin energjetik dhe duke harmonizuar organizimin bashkiak. Perspektiva për pranim në BE ofron një spirancë të fortë për vijimin e kësaj tendence. Paralelisht, integrimi rajonal në Ballkanin Perëndimor dhe marrëdhëniet e rajonit me BE-në po përfitojnë nga një shtytje e re politike, pas Konferencës së nivelit të lartë të Berlinit në gusht të 2014-ës. Kjo pritet të krijojë një mjedis mbështetës për aktivitetet e Bankës gjatë katër viteve të ardhshme. Në të njëjtën kohë, sfidat mbeten ende të pranishme. Prodhimi me vlerë të shtuar të ulët mbulon pjesën më të madhe të ekonomisë, ndërsa ndërmjetësimi financiar kufizohet nga nivelet shumë të larta të huave të këqija, i cili nga ana e tij, pengon konkurrueshmërinë e sektorit privat. Kjo situatë komplikohet nga historia e izolimit të Shqipërisë përpara vitit 1991, e cila trashëgoi infrastrukturë, investime dhe lidhje tregtare të kufizuara me rajonin e gjerë. Për më tepër, kompanitë e energjisë dhe shërbimeve bashkiake nuk operojnë mbi baza të qëndrueshme. Në këtë kontekst, orientimet e mëposhtme strategjike propozohen për të mbështetur angazhimin e BERZH-it në Shqipëri në periudhën strategjike të rradhës:

- **Mbështetje e konkurrueshmërisë së sektorit privat duke rritur krijimin e vlerës, duke lehtësuar aksesin e SME-ve tek financat dhe duke forcuar një mjedis mundësues për biznesin:** Kushtet për të bërë biznes vazhdojnë të jenë sfiduese. Në veçanti SME-të po vuajnë për shkak të kombinimit të aksesit të kufizuar në financim, korrupsionit dhe pasigurisë për të drejtat e tokës dhe të pronës. Aktivitetet informale janë depërtuese, duke penguar përpjekjet e kompanive të jenë të gatshme të operojnë sipas rregullave. Banka do të mbështesë korporatat dhe SME-të në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet financimit të borxhit dhe financimit të kapitalit, si dhe për këshillimin e biznesit, me synimin e forcimit të konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve përmes përmirësimit të aftësive, investimeve në teknologjinë moderne, eficientë energjetike, qeverisjen e mirë, praktika dhe standarde më të mira biznesi. Po ashtu, Banka do të përpiqet të ndihmojë në fillimin e kreditimit për sektorin privat përmes produkteve për ndarjen e riskut dhe linjave të dedikuara të kreditimit me bankat tregtare, si dhe nëpërmjet angazhimit në këshillimin e politikave për zgjidhjen e huave të këqija. Së fundmi, duke mbështetur momentin e rimëkëmbur të reformave të qeverisë, Banka do t'i zgjerojë aktivitetet e saj në kuadrin e Iniciativës për Investimet, Klimës dhe Qeverisjen (ICGI).
- **Zgjerim i tregjeve duke forcuar lidhjet rajonale:** Si ekonomi e vogël, e hapur, Shqipëria mund të përfitojë shumë nga zgjerimi i lidhjeve ekonomike me vendet

fqinje, duke u mbështetur në frymën pozitive të bashkëpunimit rajonal që ka marrë jetë vitet e fundit. Nevojitet një qasje gjithëpërfshirëse rajonale për përmirësimin e infrastrukturës ndërkufitare, lidhjeve energjetike dhe uljen e pengesave jotarifore për tregtinë. Për t'i trajtuar këto nevoja, Banka do të punojë ngushtë me BE dhe partnerët e tjerë të saj në Kuadrin e Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF), e cili gjithnjë e më tepër po thekson projektet që nxisin konektivitetin. Në veçanti, Banka do të kërkojë mundësi për të mbështetur zgjerimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës rajonale të transportit për të lehtësuar lidhjet ndërkufitare dhe për të ulur kostot e transportit. Për të forcuar sigurinë energjetike, ajo do të mbështesë dhe interkoneksionet energjetike dhe të gazit me vendet fqinje. Banka do të mbështesë po ashtu investitorët e huaj në Shqipëri dhe do të lehtësojë tregtinë duke ofruar burime financiare dhe ndërtim kapacitetesh për SME-të e orientuara drejt eksportit.

- **Promovimi i qëndrueshmërisë së ndërmarrjeve publike nëpërmjet komercializimit dhe pjesëmarrjes së sektorit privat:** Shqipëria haset me sfida të mëdha për vendosjen e ofrimit të shërbimeve bashkiake dhe të energjisë në bazë të qëndrueshme. Në përputhje me rrethanat, Banka do të eksplorojë mënyra për të mbështetur më mirë ristrukturimin e thellë të sektorit energjetik, të udhëhequr nga Banka Botërore. Në varësi të progresit për zhvillimin e një mjedisi rregullator të favorshëm dhe të besueshëm, kjo mund të përfshijë ofrimin e financimit për prodhuesit e pavarur privatë të energjisë nga burimet hidrike. Banka mund të angazhohet po ashtu në ristrukturimin e kompanive shtetërore të energjisë elektrike në prodhim, transmetim dhe shpërndarje, me kusht që të ketë një angazhim të besueshëm nga qeveria për komercializim. Me ecjen përpara të reformës territoriale, Banka do të synojë të angazhohet në financimin e infrastrukturës bashkiake dhe mjedisore.

### 3.2 Sfidat kyçe dhe aktivitetet e Bankës

#### **Tema 1: Mbështetje për konkurrueshmërinë e sektorit privat duke nxitur krijimin e vlerave, duke lehtësuar aksesin në financë dhe forcuar një mjedis mundësues biznesi**

##### Sfidat e tranzicionit

- Edhe pse cilësia e mjedisit të biznesit është përmirësuar në përgjithësi gjatë viteve të fundit, sondazhet e ndërmarrjeve tregojnë që problemet me infrastrukturën (veçanërisht e furnizimit me energji), korrupsioni dhe informaliteti endemik mbeten pengesa të rëndësishme për zhvillimin e biznesit. Sistemi i dobët gjyqësor është një tjetër pengesë për zhvillimin e një ekonomie tregu eficiente.
- Një pjesë e madhe e ekonomisë mbështetet në aktivitetet me vlerë të shtuar të ulët. Lëvizja më lartzinxhirit të vlerave është e vështirë për shkak të mungesës së aftësive të orientuara nga tregu, veçanërisht tekata që hyjnë rishtazi në tregun e punës, si dhe qeverisja e dobët e korporatave dhe standardet e dobëta menaxheriale.
- Mungesa e të drejtave të qarta mbi pronësinë është një problem i vazhdueshëm në Shqipëri. Në veçanti, pasiguria e lidhur me titujt e pronësisë përbën një pengesë të qartë për investimet në prona dhe turizëm dhe ka ndikim po ashtu dhe në sektorin e agrobiznesit. Në sektorin e agrobiznesit, sfida kryesore është përmirësimi i regjistrit të tokës dhe sistemi i kadastrës për të lehtësuar transferueshmërinë e tokës dhe konsolidimin aq të nevojshëm të fermave të vogla.

- Aksesit në financë mbetet i vështirë, veçanërisht për SME-të. Pavarësisht nivelit të lartë të likuiditetit të bankave (57 përqind në raport me depozitat), portofolet e kredive po kontraktohen teksa borderotë janë ngarkuar me hua të këqija (22-24 përqind).
- SME-të e drejtura nga gratë luftojnë veçanërisht nga pengesat shtesë të natyrave financiare dhe jofinanciare. Këto pengesa përfshijnë nivelet e ulëta të pronësisë mbi pronat të grave, gjë e cila e bën të vështirë të merret kolaterali i nevojshëm për sigurimin e kredive, mungesa e aftësive dhe rrjeteve të biznesit, më pak eksperiencë pune e mëparshme krahasuar me punën e burrave dhe më shumë kërkesë për kohë për t'u kujdesur për aktivitetet e lidhura me kujdesin ndaj fëmijëve për gratë, gjë e cila i lë ato me më pak kohë për t'ju kushtuar biznesit, duke pasur ndikim në përzgjedhjen e tyre dhe rrugën e rritjes së biznesit.
- Sfida të mëdha tranzicioni ekzistojnë po ashtu dhe për sektorin financiar jo bankar. Kapitali privat është praktikisht i panjohur, tregjet kapitale nuk funksionojnë si burim i kuptimtë i financimit afatgjatë të ekonomisë dhe nivelet e sigurimit dhe të penetrimit të lizingut janë relativisht të ulëta në krahasim me vendet e tjera.

### Fokusi operacional

- Banka do të vijojë t'i mbështesë korporatat dhe SME-të në Shqipëri përmes financimit të borxhit dhe të kapitalit me synimin e inkurajimit të një prodhimi më të lartë të vlerës së shtuar, prezantimit të teknologjive dhe standardeve të reja dhe promovimit të qeverisjes së mirë. Këto investime do të përqendrohen tek fusha ku Shqipëria ka avantazhe krahasuese, përfshirë përmes pasurisë së saj në burime natyrore (p.sh. kushte të mira të hidrocentraleve, pasuri minerare, depozita të përshtatshme naftë dhe gazit dhe vijës bregdetare atraktive) dhe kostove të saj konkurruese të punës (p.sh., në agrobiznes, shërbimet ndërkombëtare të biznesit, prodhim, logjistikë dhe mikpritje).
- Përmes mbështetjes për biznesin e vogël, Banka do të përpiqet të ndërtojë kapacitete dhe të forcojë konkurrueshmërinë e SME-ve lokale duke ofruar shërbime këshillimore, ndër të tjerash, në fushat e marketimit, strategjisë dhe menaxhimit të cilësisë. Në mbështetje të aksesit të SME-ve për financimin, ajo do të përpiqet po ashtu të rrisë njohuritë financiare të kompanive lokale nëpërmjet mbështetjes me financime nga donatorët për kontabilitet, auditim financiar, planifikim financiar dhe të korporatave, këshillim për konsolidim dhe ristrukturim. Sinergjitë me produktet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të financimit të Bankës do të realizohen përmes një kombinimi të këshillimit dhe financimit për bizneset e vogla, si dhe duke dhënë produkte të dedikuara të integruara financiare dhe mbështetje për gratë në biznes, dhe potencialisht, në agrobiznes, si dhe në eficientësinë e burimeve të qëndrueshme dhe energjisë.
- Banka do të përpiqet të prezantojë instrumente të reja në sektorin bankar, në mënyrë që të mund t'i shërbejë sa më mirë ekonomisë reale. Për shkak të likuiditetit të lartë, por hapësirës së kufizuar të kapitalit për shumë banka, Banka do të përqendrohet tek produktet me ndarje rrisje mbi bazë projekti (Instrumenti për Ndarjen e Riskut – ish MCFF), ose në bazë portofoli (p.sh. Gratë në Biznes për të trajtuar hendeqet e mëdha gjinore në aksesin në financë, Marrëveshjen e Financimit të Agrobiznesit për të përmirësuar arritjen e këtij sektori shumë të fragmentarizuar nga Banka). Këto produkte mund të shoqërohen nga mbështetje për ndërtimin e kapaciteteve për bankat si dhe për huamarrësit fundorë.
- Në projektet e saj me korporatat, Banka do të kërkojë mundësi për të mbështetur zhvillimin e politikave dhe praktikave të barabarta dhe për të zhvilluar diversitetin në krahun e punës së këtyre kompanive. Ajo do të eksplorojë po ashtu mënyra për

përmirësimin e standardeve të trajnimit dhe disponueshmërinë e mundësive të të mësuarit nëpërmjet punës për të rinjtë.

### Dialogu për politikat

- Mbështetur në Memorandumin e Mirëkuptimit për Iniciativën për Investimet, Klimën dhe Qeverisjen, nënshkruar nga Qeveria Shqiptare dhe Banka në vitin 2014, Banka do t'i zgjerojë aktivitetet e veta në mbështetje të një klime biznesi mundësuese dhe qeverisjeje të mirë. Banka do të vazhdojë të sponsorizojë me fonde donatoresh sekretariatit profesional të Këshillit të Investimeve, duke mbështetur një reformë për dialog të strukturuar dhe sistematik ndërmjet sektorit publik dhe sektorit privat për të përmirësuar klimën e biznesit. Banka do të kërkojë po ashtu të ofrojë mbështetje për lehtësimin e procedurave të regjistrimit të biznesit, përmirësimin e praktikave të prokurimeve dhe zgjerimit të mekanizmave për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (arbitrazhit dhe ndërmjetësimit). Më tej, Banka do të eksplorojë mundësitë për të trajtuar disa nga dobësitë kyçe të sistemit gjyqësor (p.sh., përmes ofrimit të trajnimit për gjyqtarët) dhe për të ulur informalitetin dhe luftuar korrupsionin, të cilat janë pengesa kryesore për zhvillimin e sektorit privat.
- Banka do të ndihmojë në trajtimin e problemit të huave të këqija në sektorin bankar, nën lidhshiripin e FMN-së, duke përdorur platformën e Iniciativës së Vjenës dhe duke punuar ngushtë me Grupin e Bankës Botërore dhe me BE-në.

**Kuadri i rezultateve për temën 1: Mbështetje për konkurrueshmërinë e sektorit privat duke nxitur krijimin e vlerave, lehtësuar aksesin në financë dhe forcuar një mjedis mundësues biznesi**

	SFIDAT	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET	TREGUESIT GJURMUES
1.1	Mungesa e aftësive të orientuara drejt tregut, qeverisja e dobët e korporatave dhe standardet e dobëta pengojnë zhvillimin e aktiviteteve me vlerë të shtuar të lartë	<b>Përmirësimi i konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve nëpërmejt përmirësimit të aftësive, teknologjisë së re, praktikave dhe standardeve të qeverisjes</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Investime për të nxitur vlerën e shtuar të lartë, teknologjitë e reja, transferimin e aftësive, përmirësimin e standardeve dhe qeverisjen e mirë (përfshirë politikat e mundësive të barabarta, aty ku është e mundur)</li> <li>Këshillim për Mbështetjen e Biznetit të Vogël (SBS) për standardet operative dhe menaxheriale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Prova të rritjes së produktivitetit tek firmat e klientëve (përf. Treguesin e SBS-së për numrin e projekteve që kanë raportuar produktivitet të rritur) (<i>Bazë – e krijuar me propozim projekti</i>)</li> <li>Prova të prezantimit të suksesshëm të qeverisjes më të lartë të korporatave dhe standardeve të biznesit nga klientët (<i>Bazë – 0</i>)</li> </ul>
1.2	Pavarësisht nga lukuiditeti i lartë, portfolet e kreditimit janë duke u kontraktuar, pasi borderotë e bankave janë të ngarkuara nga huatë e këqija NPL (ndërmjet më të lartave në rajon)	<b>Mbështetje për aksesin në financim për sektorin privat duke kontribuar për rishikimin e huadhënies nga bankat</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndarja e riskut mbi bazë projekti/portofoli</li> <li>Fusha të dedikuara (Marrëveshja Financimit të Agrobiznesit, Gratë në Biznes, burimet e qëndrueshme dhe efica mjaftësore), me ndërtim kapacitetesh për bankat</li> <li>Forcimi i bankimit/informacionit financiar të SME-ve nëpërmjet këshillimit për SBS-të.</li> <li>Angazhimi me pjesëmarrësit rregullatorë dhe të tregut për çështjen e huave të këqija në platformën e Vjenës (e drejtuar nga FMN-ja në Shqipëri)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri/volumi total i nënkredive të MSME-ve të dhëna nga bankat kliente, përf. fushat e identifikuar të synuara (sipërmarrëset gra, efica mjaftësore agro, energjetike) (<i>Bazë – e përcaktuar me miratimin e projektit</i>)</li> <li>Pjesa e përfituesve të SBS-së të cilët do të marrin financim brenda një viti pas përfundimit të projektit (<i>Bazë – Vendosur në fazën e miratimit të projektit</i>)</li> </ul>
1.3	Dobësi në sistemin gjyqësor, mungesë e qartë e të drejtave të pronësisë, korrupsion dhe konkurrencë e padrejtë nga sektori informal janë pengesat kryesore për zhvillimin e biznesit	<b>Trajtimi i pengesave ligjore dhe rregullatore për zhvillimin e sektorit privat dhe lehtësimi i dialogut publik / privat për të përmirësuar klimën e investimeve</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbështetje për sekretariatën e Këshillit të Investimeve si platformë e pavarur dhe profesionale për dialogun e reformave sektoriale publike/private</li> <li>Aktivitete të mëtejshme nën Iniciativën e Klimës së Investimeve dhe Qeverisjes (p.sh., prokurimet, regjistrimi i biznesit, trajnimi për gjyqtarët, qeverisja e korporatave, zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve, masat për uljen e informalitetit dhe trajtimin e korrupsionit)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Prova për përmirësimin e klimës së biznesit përmes ndryshimeve specifike në zhvillimin e biznesit (p.sh., praktikat e prokurimit, procedurat e regjistrimit, ndërtimi i kapaciteteve në sistemin gjyqësor, përmirësimi i praktikave për qeverisjen e korporatave në sektorin bankar dhe të korporatave), si rezultat i dialogut të politikave të Bankës (<i>Bazë – P/P</i>)</li> </ul>
Treguesi i kontekstit: Δ Indeksi i sofistikimit të biznesit (bazë 2014-2015: rezultati 3.6 / renditja e 104 <sup>te</sup> ). <i>Burimi: Indeksi Global Konkurrues (WEF)</i>				

## Tema 2: Zgjerimi i tregjeve duke forcuar lidhjet rajonale

### Sfidat e tranzicionit

- Historia e Shqipërisë me thuajse izolim të plotë përpara vitit 1991 ka lënë një trashëgimi që është ende e dukshme sot. Cilësia e infrastrukturës është goxha më pas cilësisë së vendeve të tjera në rajon dhe përbën pengesë për integrimin rajonal.
- Në sektorin energjetik, sfida kryesore është zhvillimi i infrastrukturës së rrjetit për të lejuar rritjen e tregtisë ndërkufitare, uljen e humbjeve dhe rritjen e rolit për operatorët e sektorit privat, si dhe një furnizim më stabil me energji, ndërsa prodhimi i energjisë elektrike në vend varet shumë nga kushtet e motit.
- Shqipëria nuk është e lidhur me asnjë rrjet kryesor për shpërndarjen e gazit dhe nuk ka një rrjet të përshtatshëm kombëtar për këtë gjë. Gazsjellësi Trans-Adriatik, i cili pritet të fillojë së funksionuari pas vitit 2020 dhe do të kalojë përmes Shqipërisë, mund të jetë ndryshues loje në këtë kuadër, duke e bërë Shqipërinë një pikë kyçe për daljen e gazit drejt Italisë dhe rajonit të Evropës Juglindore. Për më tepër, kompanitë private kanë treguar interes në potencialin e tregut shqiptar. Megjithatë, projekti do të duhet të mbështetet nga një strategji e mirëplanifikuar gazifikimi.
- Gjatë viteve të fundit është bërë progres i madh për ndërtimin e rrugëve dhe kufijve me shtetet fqinje, dhe tani ekziston dhe një Agjenci për Rrugët (ARA). Sfidat aktuale janë zhvillimi i përfshirjes së tregut privat për zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës rrugore, prezantimi i një marrëveshjeje në nivel shërbimi dhe përmirësimi i qeverisjes së korporatave brenda ARA-s.
- Sektori hekurudhor vuan nga mungesa e rëndë e investimeve për dekada. Nga perspektiva rajonale, sfidat kryesore përfshijnë përmirësimin e rrjedhjeve të rrjetit në planifikimin e rrjetit TENS dhe përparësitë e financimit, dhe prezantimi i konkurrueshmërisë në bizneset hekurudhore.
- Integrimi rajonal pengohet nga vështirësitë në tregtim përtej kufijve; Shqipëria renditet në vendin e 95<sup>th</sup> në këtë kategori në raportin e fundit *Doing Business* të Bankës Botërore. Duhet të trajtohen pengesat tregtare jo tarifore për të inkurajuar prurje më të mëdha të kufijve ndërtregtarë.

### Vëmendja operative

- Banka do të kërkojë mundësi për të promovuar dhe mbështetur zgjidhjet tregtare për zhvillimin e infrastrukturës të transportit rajonal për të forcuar lidhjet ekonomike të rajonit, duke punuar ngushtë me BE dhe partnerët e tjerë në Kuadrin e Investimeve të Ballkanit Perëndimor. Duke lejuar hapësirë fiskale, Banka do të shqyrtojë financimin, së bashku me Bankën Botërore, të programit të investimit të qeverisë për mirëmbajtjen e rrjetit rrugor. Përmes këtyre projekteve, Banka do të kërkojë të rrisë pjesëmarrjen e sektorit privat për financimin e projekteve të transportit.
- Banka do të kërkojë të mbështesë kompaninë e transmetimit të enegjisë, nëse është e mundur jo në bazë sovraane, me synimin e integritetit të mëtejshëm të Shqipërisë në tregun rajonal të energjisë dhe të ndihmës për hapjen e tregut për operatorët privatë.
- Banka do të shqyrtojë financimin e transmetimit të gazit (Gazsjellësi Trans-Adriatic Pipeline), si dhe shpërndarjen e gazit bazuar në rezultatet e masterplanit për gazin, për të mbështetur diversifikimin e burimeve energjetike, rritur sigurinë energjetike të Shqipërisë dhe mbështetur zhvillimin e një tregu rajonal gazi.

- Banka do të vijojë ta mbështesë Shqipërinë duke kërkuar të ofrojë linja kreditimi për financimin e tregtisë nëpërmjet bankave partnere, si dhe këshillimit të biznesit për bizneset e vogla për gatishmërinë për eksport.
- Banka do të kërkojë mundësi bashkëfinancimi me sponsorizuesit e huaj të interesuar për të investuar në Shqipëri, përfshirë kompanitë ose fondet e investimeve me prani ekzistuese në rajon dhe do të mbështesë zgjidhjet rajonale për tregjet kapitale dhe zgjerimin e lidhjeve financiare rajonale.

#### Dialogu për politikat dhe kapacitetet teknike

- Banka do të vijojë ta këshillojë Ministrinë e Transportit për zhvillimin e një plani të qëndrueshëm transporti, të synuar për uljen e konsumit të energjisë në sektorin e transportit dhe përcaktimin e objektivave për efikasitetin energjetik. Në nivelin kombëtar, kjo do të përfshijë përcaktimin e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm të rrjetit të transportit multimodal, dhe më pas artikullimin sesi mund të arrihen këto objektiva përmes planit të masave.
- Banka do të vijojë të japë këshillim për zhvillimin e një strategjie kombëtare për pagesat për rrugët, duke shprehur përfitimet e pagimit për përdorimin e rrugëve, duke përcaktuar strukturën optimale tarifore dhe duke identifikuar seksionet e mundshme të përshatshme për pagimin e tarifave të rrugëve.
- Banka do të vijojë të mbështesë, si institucionin ndërkombëtar financiar drejtues, ndihmën teknike për projektimin e detajuar për rehabilitimin e hekurudhës Durrës-Tiranë (përf. Lidhjen me aeroportin), si dhe vlerësimin financiar dhe ekonomik të të gjithë rrjetit hekurudhor shqiptar. Banka do të shqyrtojë mundësinë e projekteve pasuese të investimeve.
- Banka do të mbështesë masterplanin për gazin si institucioni ndërkombëtar financiar drejtues nën Kuadrin e Investimeve për Ballkanin Perëndimor, për të mbështetur sa më mirë në të ardhmen gazsjellësin Trans-Adriatic, i cili kalon përmes Shqipërisë, dhe për të ndërtuar një sistem gazi natyror që kontribuon për konkurrueshmërinë e ekonomisë. Masterplani do të marrë parasysh përzierjen ekzistuese energjetike, çështjet të sigurimit të furnizimit me gaz natyror, si dhe kërkesat mjedisore.

### Kuadri i rezultateve për Temën 2: Zgjerimi i tregjeve duke forcuar lidhjet rajonale

	SFIDAT	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET	TREGUESIT GJURMUES
2.1	Cilësia e infrastrukturës është goxha më pas cilësisë së vendeve të tjera në rajon dhe përbën pengesë për integrimin rajonal	<b>Mbështetja e zgjerimit dhe rehabilitimit të infrastrukturës rajonale të transportit për të lehtësuar tregtinë ndërkufitare dhe për të ulur kostot e transportit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Financimi i ndërtimit dhe mirëmbajtjes së lidhjeve rajonale të transportit</li> <li>▪ Mirëmbajtje dhe siguri për rrugët kombëtare</li> <li>▪ Ndërtim kapacitetesh për një plan të qëndrueshëm transporti dhe një strategji kombëtare për vendosjen e pagimit të tarifave për përdorimin e rrugëve</li> <li>▪ Institucioni ndërkombëtar drejtues për studimin e rehabilitimit të hekurudhave</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dëshmitë e shërbimeve rajonale të transportit që përfshijnë në mënyrë të suksesshme zgjidhjet tregtare (<i>Baza – 0</i>)</li> <li>▪ Progres i demonstruar për sektorin në sektorin rrugor (përmirësim i qëndrueshmërisë financiare dhe energjetike) (<i>Bazë – N/A</i>)</li> </ul>
2.2	Prodhimi i energjisë elektrike në vend është i brishtë (i varur nga moti) ndërsa furnizimi me gaz inekzistent, ndërsa duhet të zhvillohen ndërlidhjet rajonale	<b>Kontribut për zgjerimin e interkonektivitetit të energjisë me vendet fqinje për të përmirësuar sigurimin e energjisë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Financimi i transmetimit të energjisë dhe promovimi i hapjes së sektorit për operatorët privatë</li> <li>▪ Gazsjellësi Trans-Adriatik (në varësi të progresit të TAP-it)</li> <li>▪ Institucioni ndërkombëtar drejtues për masterplanin e studimit për gazin</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dëshmitë e zgjerimit të suksesshëm të infrastrukturës rajonale të transmetimit të energjisë dhe gazit me mbështetjen e Bankës (<i>Bazë – 0</i>)</li> <li>▪ Dëshmitë e masave që po merren bazuar në rekomandimet e Bankës për masterplanin e gazit (<i>Bazë – N/A</i>)</li> </ul>
2.2	Vështirësitë në tregtim ndërmjet kufijve mbeten ende të pranishme, ndërsa duhet të inkurajohen investimet në gjithë rajonin	<b>Mbështetje për tregtinë dhe prurjet e investimeve me rajonin e gjerë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Linja kreditimi të financimit të tregtisë</li> <li>▪ Këshillim i SBS-së për gatishmërinë e eksporteve</li> <li>▪ Bashkëfinancimi i investime të huaja direkte në hyrje /në dalje dhe mbështetje për lidhjet financiare rajonale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <math>\Delta</math> në përqindje të eksporteve në xhiron totale të klientëve SBS të orientuar drejt eksportit (<i>Baza – e krijuar me miratim të projekteve</i>)</li> </ul>
Tregues i kontekstit: $\Delta$ Indeksi i sofistikimit të biznesit (bazë 2014-2015: rezultati 3.6 / renditja e 104 <sup>te</sup> ). <i>Burimi: Indeksi Global Konkurrues (WEF)</i>				



### **Tema 3: Promovimi i qëndrueshmërisë së ndërmarrjeve publike përmes komercializimit dhe pjesëmarrjes së sektorit privat**

#### Sfidat tranzitore

- Sektori energjetik është i pllakosur nga një sërë shqetësimesh, të cilat po qeveria po përpiqet t'i trajtojë aktualisht. Sfidat kyçe për arritjen e qëndrueshmërisë afatgjatë përfshijnë: (i) rritje e konkurrueshmërisë nga sektori privat si në prodhim dhe në furnizimin me pakicë; (ii) përmirësim i mëtejshëm i mbledhjes së faturave dhe përforcimi i disiplinës së pagimit; dhe (iii) prezantimi i tarifave me kosto efektive për konsumatorët fundorë; dhe (iv) promovimi i veçimit efektiv në sektorin energjetik së bashku me përmirësimin e operimit eficient dhe qeversijes së korporatave për kompanitë e rrjetit.
- Pasiguria rregullatore është një tjetër sfidë për qëndrueshmërinë energjetike. Mungesa e pavarësisë dhe transparencës ka ndikim veçanërisht tek prodhuesit e hidrocentraleve të vogla kur bëhet fjalë për ushqyerjen e mekanizmit tarifor.
- Ofrimi i shërbimeve bashkiake mbetet shumë i centralizuar në Shqipëri. Për pasojë, një sfidë kyçe është forcimi dhe përmirësimi i autonomisë financiare për bashkitë dhe ndërmarrjet bashkiake nën rregullim efektiv. Reforma territoriale ka ulur ndjeshëm numrin e bashkive. Si hap pasues, duhet të ndiqet decentralizimi fiskal për të krijuar njësi bashkiake të bankueshme.

#### Vëmendja operative

- Në varësi të projektit për rimëkëmbjen e energjisë të drejtuar nga Banka Botërore dhe zhvillimit të një kuadri të favorshëm dhe të besueshëm të kuadrit rregullator, Banka do të kërkojë të riangazhohet në investime në prodhimet hidrologjike. Kjo mund të përfshijë si rehabilitimin e hidrocentraleve ekzistuese si edhe ndërtimin e hidrocentraleve të reja nga kompanitë private të pavarura të prodhimit të energjisë. Banka do të eksplorojë po ashtu dhe mundësi për të mbështetur forma të tjera të prodhimit të energjisë së rinovueshme (p.sh., nga era, diellore) bazuar në strategjinë e ardhshme të qeverisë për burimet e rinovueshme energjetike.
- Në varësi të planeve të autoriteteve, Banka do të eksplorojë sesi të angazhojë më mirë kompanitë shtetërore të energjisë (KESH, OST, OSHEE) për të lehtësuar ristrukturimin dhe komercializimin e tyre dhe për të financiar përparësitë e tyre të investimeve, kur është e realizueshme.
- Me vijimin e reformës territoriale, Banka, në bashkëpunim të ngushtë me partnerë të tjerë ndërkombëtarë, do të synojë të përfshihet në financimin e infrastrukturës bashkiake dhe mjedisore dhe t'i ndihmojë ndërmarrjet lokale të përgatiten për autonomi më të madhe financiare, duke e vënë theksin kryesisht tek transporti urban dhe ndriçimi i rrugëve, por duke u zgjeruar mbase dhe në sektorin e ujit, kanalizimeve dhe mbetjeve të ngurta. Kjo mund të bëhet nëpërmjet mbështetjes nga fondet e BE-së, ose burime të tjera grantesh. Kur është e mundur dhe e përshtatshme, Banka do të mbështesë po ashtu pjesëmarrjen e sektorit privat në ofrimin e shërbimeve bashkiake, me Tiranën si kryeqytet që do të jetë pika nisëse për këtë gjë.

#### Dialogu për politikat dhe kapacitetet teknike

- Banka Botërore po merr drejtimin e politikave në mbështetje të rimëkëmbjes së sektorit energjetik. Banka do të vijojë të eksplorojë se ku është më e përshtatshme për

të dhënë këshillim për politikat dhe do të ofrojë kapacitete teknike në rastin kur të ketë prezencë të fortë biznesi.

- Angazhohet në dialogun e politikave dhe punën analitike për komercializimin e shërbimeve bashkiake.
- Si pjesë e mbështetjes së saj për Ministrinë e Transportit në zhvillimin e një plani të qëndrueshëm, Banka do të ndihmojë në zhvillimin e politikave më të mira për eficientë energjetike të transportit urban, e cila do të zbatohet në nivelin bashkiak.
- Me daljen në pah të mundësive, Banka do të ndihmojë në projektimin e shërbimeve bashkiake që u japin përgjigjen çështjeve gjinore dhe i plotësojnë nevojat e përdoruesve të ndryshëm.

**Kuadri i rezultateve për temën 3: Promovimi i qëndrueshmërisë së ndërmarrjeve publike përmes komercializimit dhe pjesëmarrjes së sektorit privat**

	<b>SFIDAT</b>	<b>OBJEKTIVAT</b>	<b>AKTIVITETET</b>	<b>TREGUESIT GJURMUES</b>
3.1	Mungesë konkurrence në prodhim me pakicë, disiplinë e dobët pagimi, tarifa nën kosto dhe pasiguria rregullatore janë sfidat kryesore për qëndrueshmërinë e sektorit energjetik	<b>Puna me BB-në dhe me institucione të tjera ndërkombëtare financiare, kontribut për zgjerimin e qëndrueshmërisë në sektorin energjetik</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Në varësi të progresit të projektit të rimëkëmbjes energjetike të Bankës Botërore dhe përmirësimeve në mjedisin rregullator, promovim i hidrocentraleve (përmes kapacitetit të ri të instaluar dhe rehabilitimit të aseteve ekzistuese) dhe formave të tjera të energjisë së rinovueshme</li> <li>▪ Në varësi të planeve nga autoritetet, mbështetje për ristrukturimin dhe komercializimin e kompanive shtetërore të energjisë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kapaciteti total i energjisë së rinovueshme të instaluar dhe rikonstruktuar me mbështetjen e Bankës (<i>në MW, Bazë – 158,746 MWh/y for 2006 – 2014</i>)</li> <li>▪ Dëshmitë e përmirësimeve në qeverisjen e korporatave dhe praktikave të biznesit të kompanive të KESH-it si rezultat i aktiviteteve të Bankës (<i>Bazë – P/P</i>)</li> </ul>
3.2	Ofrimi i shërbimeve bashkiake mbetet ende goxha i centralizuar. Duhet të përmirësohet autonomia financiare e bashkive dhe ndërmarrjeve bashkiake.	<b>Ndihma për reformën territoriale dhe promovimi i komercializimit të shërbimeve bashkiake</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Investime në transportin urban dhe inter-urban, ndriçimin e rrugëve dhe mbase dhe ujin, kanalizimet dhe mbetjet e ngurta, me mbështetje teknike për përmirësimin e performancës financiare dhe operative.</li> <li>▪ Angazhim në dialogun e politikave dhe punën analitike për komercializimin e shërbimeve bashkiake.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përmirësime të praktikave operative (mbledhje e të ardhurave, produktivitet) dhe performanca e kostove për operatorët bashkiakë mbështetur nga Banka (<i>Baza – e përcaktuar me miratimin e projektit</i>)</li> <li>▪ Dëshmitë e suksesit të mbështetjes së dialogut analitik dhe të politikave të BERZH-it për komercializimin e shërbimeve bashkiake (<i>Bazë – N/A</i>)</li> </ul>

### 3.3 Rreziqet potenciale për zbatimin e strategjisë së vendit

Aftësia e Bankës për të realizuar strategjinë e saj në Shqipëri dhe për të arritur objektivat e synuara do të varet nga disa faktorë të cilat janë përtej kontrollit të Bankës:

- Progresi i përgjithshëm varet shumë nga vrulli i pandërprerë i reformave të qeverisë. Këtu përfshihen jo vetëm reformat legjislativë, por ajo ç'ka është më e rëndësishme, dhe zbatimi efektiv pavarësisht kapacitetit administrativ të kufizuar.
- Për të mbështetur në mënyrë efektive konkurrueshmërinë në sektorin privat (Tema 1), do të jenë të domosdoshme reforma të mëtejshme në fusha që kanë të bëjnë me klimën e biznesit. Kjo përfshin, për shembull, luftën kundër informalitetit për të lejuar zhvillimin e zinxhirëve të vlerës në vend, dhe zgjerimin e gamës së kompanive që mund të përfitojnë financim nga BERZH-i. Qëllimi i qeverisë për luftën ndaj informalitetit është i mirepritur. Për më tepër mundësia e Shqipërisë për përfitimin e investimeve të huaja direkte do të varet nga krijimi i një niveli të njëjtte funksionimi për të gjithë investitorët, aderimin korrekt ndaj marrëveshjeve egzistuese dhe respektimin e ‘rregullave të lojës’.
- Forcimi i lidhjeve rajonale (Tema 2) bazohet po ashtu në thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit rajonal, me përafrimin në BE si një forcë e rëndësishme shtytëse. Suksesi do të varet gjithashtu nga zhvillimet ekonomike të partnerëve kryesorë tregtarë dhe të investimeve të Shqipërisë.
- Nxitja e qëndrueshmërisë së ndërmarrjeve publike (Tema 3) do të kërkojë reforma të vazhdueshme, të thelluara në sektorin e energjetikës dhe veprime të vazhdueshme për ekzekutimin e pagimit të faturave të shërbimeve publike. Objekti i angazhimit tonë në infrastrukturën bashkiake do të varet po ashtu nga politikat favorizuese si në nivelin qendror dhe në atë lokal.
- Në kuadrin e hapësirës tepër të kufizuar fiskale, shumë projekte – të cilat variojnë nga infrastruktura deri tek nxitja e SME-ve – do të kenë nevojë të konsiderueshme për mbështetje nga donatorët, si për ndihmë teknike ashtu edhe për grante investimesh.
- Përfshirja e të rinjve (nën Temën 1) është një fushë e re për Bankën. Progresi do të varet nga efektiviteti i partneriteteve të jashtme të Bankës, si dhe nga gatishmëria e klientëve të sektorit privat për t'u angazhuar në këto çështje.

Banka do të përpiqet të origjinojë dhe financojë projekte në sektorin privat sipas kriterëve të bankës, megjithëse suksesi në temat 2 dhe 3 mund të ketë një ulje në investimet e Bankës në pjesën e sektorit privat gjatë periudhës së strategjisë, aktualisht në 56% në një periudhë 5 – vjeçare (të akumuluar). Ndërsa pjesa më e madhe e volumit të biznesit mund të jetë në sektorin publik, Banka do të kërkojë të ketë pjesën më të madhe të projekteve në sektorin privat. Një rritje në vëllimin e investimeve në sektorin privat nga niveli i ulët aktual do të varet gjithashtu nga progresi në klimën e investimeve, si edhe nga fluksi i IHD-ve (Investimeve të Huaja Direkte).

### 3.4 Implikime mjedisore dhe sociale të aktiviteteve të propozuara të Bankës

Pavarësisht zbatimit të vazhdueshëm të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) me BE-në, hyrë në fuqi në prill të 2009-ës, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të tjera të konsiderueshme për t'u përafruar me *acquis*-in e BE-së lidhur me disa fusha kyçe mjedisore dhe sociale.

Në fushën e cilësisë së ujit, ligji për menaxhimin e integruar të ujit hyri në fuqi në dhjetor të 2013-ës. Megjithatë, strategjia e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve nuk është miratuar ende dhe zbatimi i ligjit është ende në faza shumë të hershme. Sipas Raportit të Progresit për Shqipërinë, i botuar nga Komisioni Evropian (KE) në tetor të 2014-ës, ka vetëm tre impiante funksionale të trajtimit të ujërave të ndotura në Shqipëri, dy impiante në ndërtim e sipër, dhe tre impiante të tjera të trajtimit të ujërave të ndotur të përfunduara, por ende jo të vënë në shfrytëzim. Menaxhimi i mbetjeve është një tjetër çështje shqetësuese. Ligji "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" është ndryshuar në tetor të 2013-ës, por ai nuk është plotësisht në përputhje me *acquis*-in e BE-së. Megjithëse ka përpjekje për të përmirësuar planifikimin dhe koordinimin e politikave për menaxhimin e mbetjeve, të tilla si organi kombëtar këshillimor i formuar së fundmi dhe komiteti i menaxhimit të mbetjeve, kapaciteti i autoriteteve për menaxhimin e mbetjeve është shumë i ulët, infrastruktura është thuajse inekzistente dhe në pjesën më të madhe mbetjet hidhen në venddepozitime. Banka do të synojë ta zgjerojë aktivitetin e vet në infrastrukturën bashkiake dhe mjedisore mundësisht në sektorin e ujit, ujërave të ndotura dhe mbetjeve të ngurta për të ndihmuar në përmirësimin e infrastrukturës së vendit.

Ndotja e ajrit është një problem në rritje në Shqipëri. Legjislacioni lidhur me emetimet dhe cilësinë e ajrit nuk është i përafuar me *acquis*-in e BE-së. Përgjegjësitë e autoriteteve shtetërore për monitorimin e cilësisë së ajrit nuk janë të qarta dhe zbatimi është ende i dobët. Ndotja e ajrit, ndërmjet çështjesh të tjera, do të duhet të rishikohet në kuadrin e vlerësimit të projektit individual dhe të jetë në përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it (ESP), dhe me kërkesat për performancë (PRs).

Siguria dhe shëndeti në punë (OSH) përbën një tjetër fushë kyçe që BERZH-i do të analizojë me kujdes gjatë vlerësimeve individuale të projekteve. Shqipëria ka ratifikuar Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për sigurinë dhe shëndetin në ndërtim, kuadrin promocional për sigurinë dhe shëndetin në vitin 2014, si dhe ka miratuar një sërë rregulloresh të reja për sigurinë dhe shëndetin në punë për të harmonizuar legjislacionin e saj me *acquis*-in e BE-së. Për këtë qëllim janë trajnuar shumë inspektorë. Pavarësisht këtyre përmirësimeve, kushtet e shëndetit dhe sigurisë në punë mbeten të dobëta, monitorimi dhe raportimi i aksidenteve gjatë punës kanë nevojë për përmirësim, dhe duhet forcuar dhe aspekti i zbatimit.

Disa prej sektorëve përparësorë për Shqipërinë, të tillë si sektori i hidrocentraleve, industritë nxjerrëse, linjat e transmetimit, dhe transporti mund të përfshijnë çështje të konsiderueshme mjedisore dhe sociale të cilat do të jenë objekt analize dhe monitorimi rigoroz gjatë të gjithë ciklit të zbatimit të projektit. Në disa raste, zbatimi i suksesshëm i këtyre projekteve do të varet nga kapaciteti i autoriteteve dhe klientëve për të kuptuar dhe zbatuar kërkesat e BE-së dhe BERZH-it, në veçanti kërkesat lidhur me blerjen e tokës, zhvendosjet e popullsisë, sigurinë rrugore, shëndetin dhe sigurisë në punë, vlerësimet strategjike mjedisore dhe emetimet e gazrave serë. Banka do të kërkojë mundësi ndihme teknike për zhvillimin e instrumenteve dhe të kapaciteteve të autoriteteve dhe të klientëve në këto fusha.

Shumë njerëz nuk kanë tituj pronësie mbi tokën në Shqipëri, e shumë prej tyre nuk e kanë formalizuar tokën që kanë zënë, dhe në këtë mënyrë, e kanë "zaptuar tokën" në mënyrë informale. Kjo përfaqëson sfida kur kërkohet zhvendosje si rezultat i një projekti. Deri më sot, autoritetet e ndryshme kanë punuar mirë me Bankën për lehtësimin e legalizimit të këtyre titujve, por ky është proces që kërkon kohë.

BERZH-i do të punojë ngushtë me klientët e tij për të minimizuar ndikimet dhe maksimizuar përfitimet e projekteve, veçanërisht për ata që konsiderohen të cenueshëm. Këtu përfshihen

grupet e njerëzve të cilët po përpiqen të urbanizohen, që u mungon dokumentacioni i përshtatshëm, dhe/ose janë të vendosur në ndërtime informale, pa një titull ligjor, të cilave u mungon shpesh infrastruktura e nevojshme dhe shërbimet e tjera. Ndërsa kjo paraqet një sfidë shumë reale për BERZH-in dhe klientët e tij, analiza mjedisore dhe sociale e Bankës do të hartohet në mënyrë të tillë që të sigurojë identifikimin e grupeve të cënueshme, të cilët mund të preken në mënyrë jo përpjesëtimore nga projekti. Kjo do të bëjë të mundur si përcaktimin e masave përkatëse lehtësuese si pjesë e hartimit të projektit, ashtu dhe ndërhyrje që do të rrisin aftësinë e këtyre grupeve për të përfunduar nga projekti. Për më tepër, angazhimi i aktorëve të interesit do të bëhet në një mënyrë që merr parasysh aspektet kulturore, duke synuar përfshirjen e pjesëmarrjes së burrave dhe grave, dhe/ose të grupeve të cilët përndryshe nuk do të kishin mundësi të përfshiheshin.

### 3.5 Bashkëpunimi i BERZH-it me MDB-të

Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve financiare ndërkombëtare, institucioneve financiare të zhvillimit dhe donatorëve, është i ngushtë dhe funksionon në dy nivele. Në nivelin rajonal, Kuadri i Investimit për Ballkanin Perëndimor (WBIF) vijon të jetë një mekanizëm shumë efektiv koordinimi për aktorët, përfshirë dhe qeveritë përfutuese të shteteve të Ballkanit Perëndimor, BE-në, institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët bilateralë, për të përcaktuar përparësinë e financimit të projekteve kyçe infrastrukturore në transport, energjetikë, mjedis dhe sektorin social, si dhe për iniciativat për efikasitetin energjetik dhe zhvillimin e sektorit privat. 23 projekte janë në zbatim e sipër, ose në përgatitje për zbatim në Shqipëri, kryesisht në sektorët e energjetikës, transportit dhe mjedisit. Ndërmjet tyre, BERZH-i po merr drejtimin për masterplanin e gazit, projektimin e detajuar për linjën hekurudhore Tiranë-Durrës, dhe studimin e fizibilitetit për rrugën e bajpasit të Tiranës.

Në nivelin kombëtar, koordinimi i donatorëve funksionon përmes takimeve të rregullta të Partnerëve të Zhvillimit & Integritetit (DIP), drejtuar nga Delegacioni i BE-së, dhe përmes takimeve për projekte specifike dhe kontakteve të shpeshta bilaterale.

Për Temën 1, Banka punon ngushtë me Grupin e Bankës Botërore, delegacionin e BE-së dhe GIZ-in për përmirësimin të klimës së biznesit. Kuadri i Partneritetit me Vendlindjen e Bankës Botërore përmban një temë të fokusuar për krijimin e kushteve për përshtatshmitet e rritjes së sektorit privat. Këtu përfshihen mbështetja për reformat në fushën e klimës së biznesit, të cilat do të jenë në qendër të një huaje të re për politikën e zhvillimit. Shumë prej partnerëve ndërkombëtarë të Shqipërisë (përfshirë BE-në, UNDP-në, Cooperazione Italiana, USAID-in, GIZ-in) drejtojnë programe për të forcuar zhvillimin e SME-ve në Shqipëri. Në sektorin financiar, FMN-ja drejton punën për kapërcimin e problemit të huave të këqija, e mbështetur nga IFC-ja dhe BERZH-i.

Për Temën 2, BERZH-i punon ngushtë me BE-në për të zhvilluar infrastrukturën ndërkufitare. KfW-ja është partner kyç në transmetimin e energjisë elektrike dhe BEI dhe Banka Botërore në infrastrukturën e transportit. Për investimet më të mëdha ndërkufitare, Banka bashkëfinancon shpesh projekte me IFC-në. Shëmbuj të kësaj praktike përfshijnë rastin e *Antea Cement* dhe të *Bankers Petroleum*.

Përsa i përket Temës 3, qeveria shqiptare ka marrë mbështetje të konsiderueshme ndërkombëtare për reformën territoriale përfshirë dhe nga BE-ja, USAID-i, UNDP-ja, SIDA dhe SDC-ja. Kjo punë mund të kontribuojë në krijimin e kuadrit të kushteve të përshtatshme për zhvillimin e financave bashkiake në të ardhmen. Në sektorin e ujit, KfW-ja luan rol

kryesor. Në sektorin energjetik institucioni ndërkombëtar financiar kryesues është Banka Botërore, përmes projektit të saj për rimëkëmbjen e energjisë.

Banka punon ngushtë me partnerët ndërkombëtarë të Shqipërisë për të përdorur me sa më shumë efikasitet burimet e pakëta.

## **SHTOJCA 1 – VLERËSIMI POLITIK**

Shqipëria është e angazhuar për dhe zbaton parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut në përputhje me kushtet e specifikuara në nenin 1 të marrëveshjes themeluese të Bankës.

Kuadri kushtetues dhe rregullator për demokracinë parlamentare pluraliste ekziston. Ndarja e pushteteve dhe kontrolli e balancimi në sistemin politik, garancitë për të drejtat themelore të njeriut, mbrojtjen e pakicave dhe rolin domethënës të shoqërisë civile janë gjerësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, siç vlerësohet nga Këshilli i Evropës. Zgjedhjet përgjithësisht kryhen në një mënyrë që konsiderohet si e lirë dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare nga OSBE-ja dhe Këshilli i Evropës.

Në periudhën që prej miratimit të strategjisë së mëparëshme, Shqipëria ka bërë progres të mëtijshëm në reformat demokratike, të shtyra në një masë të konsiderueshme drejt integritimit në BE. Përmirësime janë bërë veçanërisht në fusha që konsiderohen si dobësitë kyçe në vendet e Ballkanit Perëndimor, si për shembull reforma e administratës publike dhe përgatitjet për një reforme gjithëpërfshirëse të sistemit gjyqësor. Progresi në reformat demokratike, i arritur nga autoritetet shqiptare është reflektuar në përafrimin e përshpejtuar me BE-në. Që prej miratimit të strategjisë së mëparëshme, Shqipëria ka marrë statusin e shtetit kandidat në qershor të 2014-ës. Megjithatë, mbeten ende sfida të konsiderueshme. Sipas konkluzioneve të Raportit të fundit të Progresit të Komisionit Evropian (KE) për Shqipërinë, i cili vlerëson progresin e bërë drejt plotësimit të kriterëve të Kopenhagenit, vendi duhet të ndërmarrë përpjekje të mëtijshme të qëndrueshme për zbatim reformash për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe ndalimin e ekonomisë informale.

### **Zgjedhjet e lira dhe qeveri përfaqësuese**

#### *Zgjedhje të lira, të drejta dhe konkurruese*

Zgjedhjet në Shqipëri janë kryer në një mënyrë që në përgjithësi konsiderohen nga OSBE-ja dhe Këshilli i Evropës gjerësisht si të lira, të drejta dhe konkurruese. Kuadri ligjor parashikon një bazë të shëndoshë për zgjedhje demokratike. Ai ka përfituar nga shumë valë reformash zgjedhore, përfshirë ndryshime të gjera në Kodin Zgjedhor, të miratuar në vitin 2012, mbështetur në rekomandimet e Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) dhe Komisionit për Demokraci përmes Së Drejtës të Këshillit të Evropës (Komisioni i Venecias). Katër zgjedhjet e fundit në Shqipëri (ato parlamentare në vitin 2009 dhe 2013; dhe ato lokale në vitin 2011 dhe 2015) kanë qenë të paqta, duke përfaqësuar kështu një arritje domethënëse krahasuar me zgjedhjet e fundit, të cilat janë shoqëruar shpesh nga dhuna dhe kanosjet. Megjithatë, mangësitë procedurale vijojnë të gjymtojnë zgjedhjet, të cilat, sipas OSBE-së, ende nuk i përmbushin standardet më të larta ndërkombëtare dhe praktikant më të mira për zgjedhje demokratike.

Zgjedhjet e fundit, të organizuara më 23 qershor 2013, janë monitoruar veçanërisht nga afër për shkak të rekomandimit të kushtëzuar për statusin e vendit kandidat që është dhënë nga KE-ja pak para dhënies së statusit dhe janë konsideruar gjerësisht si një test i rëndësishëm për zhvillimin demokratik të Shqipërisë. Sipas Misionit Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, i cili ka sjellë së bashku vëzhgues nga ODIHR-i, Asambleja Parlamentare e OSBE-së dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (PACE), zgjedhjet u mbajtën në



mënyrë të rregullt, në një atmosferë respekti të vërtetë për liritë themelore, dhe shkuan në mënyrë paqësore, përveç incidenteve të izoluar.

Pavarësisht nga sa u tha më sipër, janë vënë re disa mangësi, përfshirë dhe politizimin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe të institucioneve të tjera, gjë e cila minon besimin e publikut në procesin zgjedhor. Ky shqetësim është përsëritur nga Misionet e Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it në vlerësimin paraprak të zgjedhjeve të fundit bashkiake, organizuar më 21 qershor 2015.

Raporti përfundimtar i zgjedhjeve të përgjithshme të 2013-it, i nxjerrë nga ODIHR-i numëronte disa rekomandime të detajuara për tu konsideruar nga autoritetet, partitë politike dhe shoqëria civile, duke përfshirë dhe apelin për të bërë rishikime të tjera në Kodin Zgjedhor për të trajtuar mangësitë e vëna re në raportin e mëparshëm të OSBE/ODIHR-it, veçanërisht në lidhje me “sigurimin e të drejtave të barabarta për kandidatët e pavarur” dhe “parandalimin në mënyrë më efektive ... të abuzimit të burimet shtetërore, duke përfshirë dhe burimet njerëzore për qëllimet e fushatës”<sup>2</sup>.

#### *Ndarja e pushteteve dhe kontrolli e balancimi i pushteteve*

Shqipëria përdor kuadrin kushtetues dhe legjislativ të një demokracie parlamentare, të mbështetur nga ndarja e pushteteve dhe kontrolli e balancimi i pushteteve në sistemin politik, ka një legjislature të pavarur dhe procedura të përcaktuara mirë për kontrollin parlamentar në fusha të caktuara të vendimmarrjes. Ky kuadër shumë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, siç vlerësohet nga Këshilli i Evropës. Objekti i pushteteve të ligjvënësit për të siguruar llogaridhënien e qeverisë është po ashtu përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Parlamenti shqiptar me një dhomë, i përbërë nga 140 anëtarë, zgjidhet për një mandat katër vjeçar sipas një sistemi proporcional rajonal. Në përgjithësi, është bërë një farë progresi në funksionimin e Parlamentit, përfshirë transparencën dhe gjithpërfshirjen në procesin legjislativ. Megjithatë, ai vijon të vuajë nga bojkotimi periodik i anëtarëve të opozitës në parlament. Sipas përfundimeve të Raportit të fundit të Progresit “ndermarrja e masave për zgjidhjen e kultures politike përçarëse dhe sigurimi i një dialogu konstruktiv ndermjet partive në parlament.”<sup>3</sup>

Hapësira e kompetencave të ligjvënësit për t'i kërkuar llogari qeverisë dhe për të ushtruar kontroll parlamentar është gjerësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kryeministri dhe ministrat e qeverisë marrin pjesë në interpelancat që kërkohen nga opozita parlamentare dhe ministrat marrin pjesë rregullisht në seancat dëgjimore që organizohen në komisione parlamentare. Duke ushtruar të drejtën e tyre për të nisur dhe ndryshuar legjislacionin, komitetet parlamentare kanë prezantuar disa ndryshime në ligjet ekzistuese.

Qeveria e re, e krijuar në vitin 2013, ka krijuar një rrjet njësisish jetësime për të identifikuar përparësitë e politikave, duke përfshirë qeverisjen e mirë, dhe për të monitoruar progresin në zbatimin e tyre. Reforma e vetëqeverisjes lokale, e cila ka filluar në vitin 2013 dhe është ende

<sup>2</sup> Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it, Shqipëri, zgjedhjet parlamentare të 23 tetor 2013. Raporti përfundimtar, f. 29.

<sup>3</sup> Komisioni Evropian, komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, Raport Progresi i 2014-ës për Shqipërinë, 8 tetor 2014, f. 6.

në vijim, duhet të çojë, ndërmjet të tjerash, në rritjen e efikasitetit dhe llogaridhënies së qeverisë në nivelin vendor.

#### *Pushteti efektiv për qeverisje të zyrarëve të zgjedhur*

Shqipëria ka krijuar organizime institucionale, ligjore dhe financiare për të zgjedhurit vendorë për të ushtruar me efektivitet pushtetin për të qeverisur. Ata nuk janë të detyruar nga asnjë pushtet vetoje jo demokratike, apo influencë tjetër pa vend. Ashtu si dhe në vende të tjera në tranzicion, prej shumë kohësh ka një marrëdhënie të ngushtë ndërmjet biznesit dhe elitave politike. Megjithatë, kjo nuk i komprometon kompetencat e të zgjedhurve vendorë për të qeverisur vendin.

### **Shoqëria civile, Media dhe Përfaqësimi**

#### *Niveli dhe pavarësia e shoqërisë civile*

Në vend ekziston një kuadër ligjor i kënaqshëm për organizatat e shoqërisë civile, i cili është përmirësuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit, përfshirë dhe ligje që kanë të bëjnë me funksionimin e organizatave jo qeveritare. Në vitin 2014 u miratua një ligj i ri për aksesin në informacion. Procesi i regjistrimit dhe funksionimit të organizatave të shoqërisë civile është relativisht i drejtpërdrejtë dhe përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, ka ende çështje të pazgjidhura që lidhen me përkufizimin e aktiviteteve jo fitimprurëse, raportimin financiar dhe taksimin. Bashkëpunimi ndërmjet shtetit dhe organizatave të shoqërisë civile është përmirësuar. Aktualisht po përgatitet nga qeveria në konsultim me shoqërinë civile, një projektligj “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”, i cili është një platformë për dialogun e institucionalizuar ndërmjet qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile. Organizatat e shoqërisë civile, në përgjithësi konsultohen në mënyrë më të rregullt se në të shkuarën për iniciativat e politikave dhe ato ligjore. Megjithatë, proceset pasuese lënë shumë për të dëshiruar.

Aktualisht ka më shumë se 1,600 OShC të regjistruara në autoritetet tatimore në Shqipëri. Megjithatë, ka vetëm pak OShC të krijuara siç duhet e të financuara mirë, kryesisht në qytetet më të mëdha. Disa OShC janë shumë profesionale në fushat përkatëse të ekspertizës, veçanërisht ato të specializuara në çështje që lidhen me integrimin në BE, mjedisin, median dhe gjininë. Në të njëjtën kohë, puna e OShC-ve ndikohet nga polarizimi ose i vërtetë ose i perceptuar i OShC-ve dhe drejtuesve të tyre, i cili reflekton një nivel të lartë polarizimi në përgjithësi në vend. Sektori i shoqërisë civile mbetet i fragmentarizuar dhe shumë i varur nga fondet e jashtme të donatorëve, ndërsa vitet e fundit është vërejtur një tërheqje e shumë donatorëve të huaj, për shkak të riorientimit të tyre drejt rajoneve të tjera.

E drejta për të formuar sindikata mishërohet në ligj dhe të drejtat e punës dhe të sindikatave përgjithësisht respektohen në praktikë. Këshilli i ri Kombëtar i Punës organizoi mbledhjen e tij të parë në fund të 2014-ës.

#### *Pavarësia dhe pluralizmi i medias që operon pa censurim*

Pluralizmi në media, e cila operon lirshëm dhe pa censurim, është rritur në përgjithësi gjatë viteve të fundit. Ekziston përgjithësisht baza ligjore e cila është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ka mbi 250 subjekte transmetimi dhe 26 të përditshme që operojnë në Shqipëri, ndër shifrat më të larta për frymë në rajon (megjithëse qarkullimi, edhe nëse merret

për frymë, mbetet pas). Media elektronike e dominon tregun. Subjekti kryesor mediatik është Radio-Televizioni shqiptar (RTSh) publik me të dy kanalet e tij kombëtarë, i cili ka veçanërisht shumë ndikim në zonat rurale. RTSh-ja po i nënshtrohet reformave të projektuara për të rritur profesionalizimin dhe ulur politizimin e pavend. Ka po ashtu dhe dy kanale të tjera kombëtare private dhe shumë transmetues privatë rajonalë dhe lokalë.

Vitet e fundit kanë qënë dëshmitare të një rritje shumë të madhe të aksesit në Internet. Sipas Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), përqindja e popullsisë me akses në internet është rritur nga 0.1 përqind në vitin 2000 në 60 përqind në vitin 2013 dhe është rritur me më shumë sesa dyfish gjatë viteve të fundit. Media sociale po luan një rol gjithnjë e më në rritje dhe rreth 35 përqind e Shqiptarëve janë përdorues aktivë në Facebook<sup>4</sup>.

Për shkak të numrit të madh të mediave që konkurrojnë në një treg të kufizuar reklamash dhe mungesës së transparencës në financimin e tyre, vëzhguesit e medias kanë ngritur shqetësime rreth ndërhyrjes së tepërt nga interesat e biznesit dhe ato partiake. Megjithëse ka pak shoqata gazetarësh dhe sindikata, ende nuk ka një organ vetë-rregullator për median.

Janë bërë disa ndryshime në kodin civil dhe kodin penal, të cilat kanë çuar në heqjen e dënimeve me burg për shpifjen, megjithëse nuk është arritur ende dekriminalizimi i plotë i shpifjes dhe deklaratave të pavërteta.

#### *Kanalet e shumëfishta të pjesëmarrjes civile dhe politike*

Ekzistojnë kanale të shumta civile dhe të pjesëmarrjes politike, por ka mungesë rregullash dhe procedurash të përcaktuara qartë, në veçanti lidhur me konsultimet publike. Ndërsa OShC-të shpesh kërkohen të ofrojnë ekspertizën e tyre në komisionet parlamentare, kjo bëhet zakonisht mbi bazë *ad hoc*. Dokumentet që dërgohen për konsultime me publikun shpesh i paraqiten publikut në një periudhë shumë të shkurtër kohe.

#### *Liria për formimin e partive politike dhe prania e opozitës së organizuar*

Liria për formimin e partive politike garantohet nga Kushtetuta dhe zbatohet në terma praktike, theksuar nga prania e një opozite të rëndësishme që është në gjendje të bëjë fushatë lirshëm dhe të kundërshtojë iniciativat e qeverisë. Partia kryesore politike opozitare ka aktualisht 35 përqind të vendeve të parlamentin kombëtar, përfaqësuesit e saj kryesojnë disa komisione parlamentare dhe kanë shumicën dhe në disa bashki. Në zgjedhjet e fundit parlamentare në Shqipëri morën pjesë 66 parti politike, prej të cilave 63 parti u regjistruan për zgjedhjet bashkiake të organizuara në qershor të 2015-ës.

### **Shteti i së drejtës dhe aksesit në drejtësi**

#### *Epërsia e së drejtës*

Ekzistojnë garancitë e nevojshme legislative dhe institucionale për epërsinë e së drejtës. E drejta për proces të drejtë ligjor dhe liria nga arrestimi dhe ndalimi arbitrar mishërohen në Kushtetutë dhe në kodin penal. Megjithatë, çështjet që lidhen me epërsinë e së drejtës,

<sup>4</sup> ITU (2013) <http://www.itu.int/en/ITU-D/Statistics/Pages/stat/default.aspx> dhe Internet World Stats (2012) <http://www.internetworldstats.com/europa.htm#al>

përfshirë dhe “dekriminalizimin” e organeve publike dhe kufizimet e imunitetit të zyrtarëve të lartë dhe gjyqtarëve vijojnë të jenë diskutueshme në Shqipëri. Kohët e fundit është krijuar një komitet parlamentar *ad hoc* i ngarkuar posaçërisht me trajtimin e "dekriminalizimit", së bashku me komisionin e posaçëm parlamentar për reformën në gjyqësor.

### *Pavarësia e gjyqësorit*

Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit garantohen nga Kushtetuta. Reforma gjithëpërfshirëse e gjyqësorit po bën progres, por mbetet ende shumë për t'u bërë për të siguruar pavarësinë e plotë të tij, transparencën, llogaridhënien dhe eficientë. Sipas Komisionit Evropian, përafrimi i Shqipërisë me standardet evropiane në fushën e gjyqësorit është në fazë të hershme. Në vitin 2014, Shqipëria kërkoi të mbështetej nga Komisioni i Venecias për të reformë strukturore të thellë dhe gjithëpërfshirëse të sistemit gjyqësor.

### *Qeveria dhe qytetarët njësoj të barabartë përpara ligjit*

Ligji i miratuar së fundmi për konfliktin e interesit dhe prokurimet publike ka filluar të zbatohet. Megjithatë, deklarimi i pasurisë së nëpunësve civilë ende nuk po kontrollon në mënyrë thelbësore.

Nevojiten masa të mëtejshme për të siguruar aksesin në drejtësi, për shembull zbatimin e Ligjit për Ndihmën Juridike Falas, i cili hyri në fuqi në vitin 2012, dhe funksionimi efektiv i Komisionit Shtetëror për Ndihmën Ligjore.

### *Politikat dhe institucionet efektive për parandalimin e korrupsionit*

Korrupsioni mbetet ende një problem serioz. Sipas Indeksit Ndërkombëtar të Perceptimit të Korrupsionit 2014 (CPI), Shqipëria zë vendin e 110<sup>të</sup> nga 176 vende të vlerësuara, duke e bërë atë një ndër vendet e renditura më ulët në Evropën Juglindore.<sup>5</sup>

Autoritetet shqiptare ‘‘kanë arritur nje nivel pergatites per luften ndaj korrupsionit’’.<sup>6</sup> Puna për strategjinë antikorrupsion dhe për planet e masave është në proces e sipër. Po ashtu, janë marrë masa ligjore për të trajtuar korrupsionin e zyrtarëve të lartë. Koordinimi është përmirësuar përmes emërimit të një Koordinatori Kombëtar për Anti-Korrupsionin dhe krijimin e një rrjeti pikash fokale të anti-korrupsionit në ministritë. Numri i hetimeve dhe numri i çështjeve të korrupsionit që i referohen prokurorisë nga policia është rritur. Megjithatë, hetimet vijojnë të jenë jo aktive ... dhe numri i dënimeve përfundimtare mbetet ende i ulët në të gjitha nivelet. Një historik solid i ndjekjeve penale dhe dënime të rasteve të korrupsionit të niveli të lartë mbetet ende sfidë.

Sipas raporteve të fundit të Grupit të Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO), ndërsa Shqipëria ka miratuar një ligj të detajuar për anti-korrupsionin dhe konfliktin e interesave, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të mbyllur hendekun e zbatimit, veçanërisht lidhur me deputetët, gjyqtarët dhe prokurorët. GRECO i ka rekomanduar autoriteteve shqiptare në veçanti që të bëjnë publike përmbajtjet e deklaramit të pasurive të deputetëve dhe t'i bëjnë këto deklarata objekt të kontroleve më të plota e më të shpeshta, të

<sup>5</sup> Transparency International, Indeksi i Perceptimeve të Korrupsionit 2014, <http://www.transparency.org/cpi2014/results>.

<sup>6</sup> Komisioni Evropian, komunikimi i Komisionit për Parlamentin Evropian për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, Shqipëri 2014, Progres Raporti, 10 nëntor 2015, f. 15.

bëjë transparente përzgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, dhe të përpunojë më tej kriteret për vlerësimin e cilësive etike të prokurorëve. Në përputhje me rregullat e GRECO-s, qeverisë do t'i duhet të parashtrojë një raport të detajuar mbi masat e marra për zbatimin e dhjetë rekomandimeve kyçe të GRECO-s deri më 30 shtator 2015.<sup>7</sup>

## **Të drejtat civile dhe politike**

*E drejta e fjalës, informacionit, fesë dhe ndërgjegjes, lëvizjes, asociimit, mbledhjes dhe pronës private*

Kushtetuta shqiptare dhe ligjet përkatëse e ndalojnë diskriminimin për shkak të seksit, racës, gjuhës, origjinës kombëtare dhe sociale, pronës ose statusit shoqëror. Kushtetuta garanton liritë dhe të drejtat bazë të qytetarëve, siç njihen nga e drejta ndërkombëtare, ndërsa traktatet ndërkombëtare janë drejtpërdrejt të zbatueshme nga gjykatat e brendshme dhe ato kanë epërsi mbi të drejtën e brendshme.

Shqipëria është palë në të gjitha instrumentet e rëndësishme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Niveli i lartë i ratifikimeve të konventave të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës dhe instrumenteve rajonale të të drejtave të njeriut përfaqëson një arritje të madhe. Shqipëria ka krijuar një kuadër institucional për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që përfshin institucionin e Avokatit të Popullit, një gamë organesh shtetërore dhe ndërministrorë dhe këshillash kombëtare, si dhe sekretariate teknike brenda ministrive. Sfidat kryesore me të cilat haset Shqipëria lidhen me ofrimin e burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare për zbatimin dhe monitorimin e këtyre instrumenteve.

Garancia kushtetuese e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë përgjithësisht respektohen dhe Shqipëria vijon të japë shembullin e harmonisë fetare në rajon. Sipas Kushtetutës së Shqipërisë, nuk ka fe shtetërore dhe të drejtat e të gjitha komuniteteve fetare (ku kryesorët janë komuniteti mysliman, (kryesisht Suni dhe Bektashi), dhe kristian (ortodoks, katolik dhe protestant) janë të garantuara në mënyrë të barabartë.

Një problem kryesor mbetet kthimi i pronës së konfiskuar gjatë komunizmit dhe zgjidhja e çështjes së titujve të pronësisë dhe pronës. Në vitin 2012 autoritetet miratuan një Strategji për të Drejtat e Pronave, duke mbuluar kthimin, kompensimin dhe legalizimin, e cila duhet rishikuar dhe zbatuar. Reforma e të drejtave të pronësisë është jetike për konsolidimin e shtetit të së drejtës, ashtu siç është dhe për zhvillimin ekonomik.

Vlerësimi i fundit i situatës së Shqipërisë në fushën e të drejtave të njeriut në kuadrin e Shqyrtimit Universal Periodik të OKB-së (UPR) u krye në vitin 2014. Tri rekomandimet kryesore për Shqipërinë përfshinin të drejtat e fëmijëve (33.33 përqind e rekomandimeve); të drejtat e grave (28.07 përqind e rekomandimeve); dhe pakicat (15.79 përqind). Shqipëria pranoi 97.66 përqind të rekomandimeve të bëra gjatë procesit të shqyrtimit.<sup>8</sup>

*Përfshirja politike për gratë, pakicat etnike dhe pakica të tjera*

<sup>7</sup> GRECO, Shqipëria, Raundi i Katërt i Vlerësimit, Parandalimi i korrupsionit lidhur me deputetët, gjyqtarët dhe prokurorët, 27 qershor 2014.

<sup>8</sup> Kombet e Bashkuara, Shqyrtimi Periodik Universal (UPR), Shqipëri, 2014 dhe Statistikat informuese të UPR-ës.

Kuadri legjislativ për mbrojtjen e pakicave etnike është gjerësisht i krijuar, përfshirë dhe Konventën e UNESCO-s për Mbrojtjen dhe Nxitjen e Diversitetit të Shprehjes Kulturore. Megjithatë, kohët e fundit është krijuar një grup pune, pas një rekomandimi të bërë nga Këshilli i Evropës, për të vlerësuar kuadrin ekzistues ligjor dhe të politikave dhe për të përgatitur përmirësimet e mundshme. Pakicat etnike marrin pjesë aktivisht në jetën politike, kryesisht përmes partive të veta politike.

Shqipëria ka një përbërje etnike më pak diverse sesa fqinjët e saj në rajon. Grekët etnikë, të cilët përbëjnë pakicën më të madhe etnike, sipas vlerësimeve të përafërta, zënë vetëm pak përqind të popullsisë. Censusi i fundit i vitit 2011 përfshiu për herë të parë pyetje optimale lidhur me origjinën etnike dhe përkatësinë fetare. Marrëdhëniet ndëretnike në vend mbeten të mira. Pakicat rome dhe egjiptiane, ashtu si dhe në shumë vende të tjera fqinje, janë grupi më i cënueshëm dhe vijojnë të përballen me vështirësi për akses në arsim, strehim dhe punësim.

Në Shqipëri ekzistojnë elementët kyçë legjislativë për barazinë gjinore. Ligje shumë të rëndësishme të miratuara vitet e fundit përfshijnë ligjin "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri", "Për Masat kundër Dhunës", "Për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë", dhe "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi". Megjithatë, aktet nën-ligjore dhe zbatimi mbeten ende të pabarabartë. Dhuna në familje kundër grave mbetet problem serioz, veçanërisht në zonat rurale. Në disa komunitete gratë janë të ekspozuara ndaj diskriminimit shoqëror sipas normave tradicionale sociale.

Gratë kanë disa përfaqësuese të profilit të lartë në nivel kombëtar. Qeveria e re shqiptare ka më shumë se 30 përqind anëtare femra. Kuotat gjinore të prezantuara në vitin 2008, të cilat parashikojnë që duhet të ketë të paktën 30 përqind gra ndërmjet kandidatëve për postet e zgjedhura në nivelin kombëtar kanë çuar në rritje të përfaqësimit të grave në parlament nga 7 përqind në të kaluarën, në 17 përqind në parlamentin aktual. Përpara zgjedhjeve të fundit zgjedhore të mbajtura në qershor të 2015-ës, u mor një vendim për të zbatuar një kërkesë të re për të përfshirë 50 përqind të secilës gjini në listat e kandidatëve duke alternuar çdo emër pasardhës. Të gjitha partitë politike e kanë respektuar këtë kërkesë.

#### *Liria nga ngacmimi, kanosja dhe tortura*

Në vend ekzistojnë garancitë kushtetuese kundër ngacmimit, kanosjes dhe torturës, të cilat zbatohen në praktikë. Një delegacion i Komitetit Evropian të Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues (CPT) vizitoi Shqipërinë për herë të fundit në vitin 2014. Raporti i fundit, i botuar në vitin 2012, njohu masat e marra nga autoritetet shqiptare për të trajtuar rekomandimet e mëparshme të CPT-së. Policia përgjithësisht perceptohet se i trajton në mënyrë korrekte të dyshuarit, por është vëre re po ashtu një numër i madh pretendimesh për keqtrajtim gjatë kohës së ndalimit.<sup>9</sup>

<sup>9</sup> Këshilli i Evropës, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimin }njerëzor dhe Degradues (CPT).

## SHTOJCA 2 – TREGUES SË PËRZGJEDHUR EKONOMIKË

Shqipëri

	2009	2010	2011	2012	2013	2014
<b>Output-i dhe shpenzimet</b>	<i>(ndryshimi në përqindje në terma realë)</i>					
PBB-ja	3.4	3.7	2.5	1.6	1.4	1.9
Konsumi privat	0.7	1.7	1.8	0.7	1.8	n/a
Konsumi publik	3.7	4.0	0.7	0.5	2.9	n/a
Formimi i kapitalit bruto fiks	1.0	-8.5	5.9	11.3	1.2	n/a
Eksportet e mallrave dhe shërbimeve	4.4	16.8	7.4	-0.6	7.9	n/a
Importet e mallrave dhe shërbimeve	-1.3	0.6	6.1	-6.6	5.0	n/a
<b>Tregu i punës</b>	<i>(ndryshimi në përqindje)</i>					
Filime mesatare mujore neto në ekonomi (mesatarja vjetore)	5.2	-3.6	4.9	2.9	-3.2	n/a
Rritja reale e pagave në njësinë e monedhës vendase	2.9	-7.0	1.5	0.8	-5.0	n/a
	<i>(në përqindje të krahut të punës)</i>					
Niveli i papunësisë	13.8	14.0	14.0	13.6	16.8	17.6
<b>Çmimet</b>	<i>(Ndryshimi në përqindje)</i>					
çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	2.3	3.6	3.5	2.0	1.9	1.6
çmimet e konsumit (në fund të vitit)	3.7	3.4	1.7	2.4	1.9	0.7
<b>Treguesit fiskalë</b>	<i>(Në përqindje të PBB-së)</i>					
Bilanci i përgjithshëm i qeverisë	-7.1	-3.1	-3.5	-3.4	-5.0	-5.0
Të ardhurat e përgjithshme të qeverisë	26.1	26.2	25.4	24.7	23.8	26.0
Shpenzimet e përgjithshme të qeverisë	33.2	29.3	28.9	28.2	28.9	31.0
Borxhi i përgjithshëm i qeverisë	59.7	57.7	59.4	62.0	64.9	69.2
<b>Sektorët monetarë dhe financiarë</b>	<i>(Ndryshimi në përqindje)</i>					
Rritja e gjerë e mjeteve monetare	6.8	12.5	9.2	5.0	2.3	3.8
Rritja e kreditimit për sektorin privat	10.3	10.1	10.4	1.4	-1.4	3.1
	<i>(në përqindje të huave në total)</i>					
Norma e huave të këqija	10.3	13.6	18.9	22.8	23.2	22.7
<b>Norma e interesit dhe e këmbimit</b>	<i>(në përqindje në vit)</i>					
Norma sipas politikave, në fund të vitit	5.25	5.00	4.75	4.00	3.00	2.25
Norma e depozitave, mesatarja vjetore	6.8	6.4	5.9	5.4	4.2	1.9
Norma e huadhënies, mesatarja vjetore	12.7	12.8	12.4	10.9	9.8	8.7
	<i>(Lek për EUR)</i>					
Norma e interesit (në fund të vitit)	137.2	138.8	138.3	139.7	140.2	140.1
Kursi i këmbimit (mesatarja vjetore)	132.1	137.8	140.3	139.0	140.3	140.0
<b>Sektori i jashtëm</b>	<i>(në përqindje të PBB-së)</i>					
Bilanci i llogarive korrente	-15.9	-11.3	-13.2	-10.2	-10.6	-14.0
Bilanci i mallrave dhe shërbimeve	-25.1	-20.6	-22.7	-18.7	-17.8	-19.7
Bilanci i tregëtisë së mallrave	-26.5	-23.2	-24.2	-20.9	-17.7	-25.4
Eksportet e mallrave	8.6	13.0	15.2	15.9	18.0	11.8
Importet e mallrave	35.2	36.2	39.4	36.8	35.7	37.1
Bilanci tregtar i shërbimeve	1.4	2.6	1.5	2.2	-0.2	5.6
Investime e huaja direkte, neto	7.9	8.8	6.6	6.8	9.5	8.3
Rezervat bruto, përjashtuar arin (në fund të vitit)	18.6	20.6	20.0	19.9	20.3	21.3
Borxhi i jashtëm, (në fund të vitit)	41.5	45.6	53.5	57.4	63.5	66.0
Borxhi i jashtëm publik	20.3	22.1	23.4	24.1	24.3	27.0
Borxhi i jashtëm privat	21.2	23.4	30.1	33.3	39.1	39.1
	<i>(në muaj të importeve të mallrave dhe shërbimeve)</i>					
Rezervat bruto ndërkombëtare	4.1	4.3	4.6	4.6	4.3	4.3
<b>Zërat e Memorandumit</b>	<i>(sipas specifikimeve)</i>					
Popullsia (në mijë)	2,928	2,913	2,905	2,900	2,897	2,958
PBB-ja (në milionë EUR)	8,662	8,997	9,268	9,605	9,730	10,092
PBB-ja për frymë (në EUR)	2,959	3,089	3,191	3,312	3,358	3,412
FDI, neto (në milionë EUR)	689	789	609	648	923	835
Borxhi i jashtëm (në milionë EUR)	3,592	4,100	4,958	5,513	6,177	6,665
Rezervat bruto (në milionë EUR)	1,646	1,905	1,912	1,972	2,015	2,148
Eksportet e mallrave dhe shërbimeve (në milionë EUR)	2,469	2,922	3,153	3,199	3,411	3,667
Instrumentet e gjëra financiare (për qind e PBB-së)	76.2	79.1	82.3	84.1	84.1	84.3

## SHTOJCA 3 – VLERËSIM I SFIDAVE TË TRANZICIONIT

Struktura e tregut	Institucionet e tregut	Sfidat kyçe
<b>KORPORATAT</b>		
<b>Agrobiznesi</b>		
Mesatare	Mesatare	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përmirësimi i regjistrimit të tokës dhe i sistemit të kadastrës për të lehtësuar transferueshmërinë e tokës, gjë që do të mbështesë konsolidimin e fermave të vogla dhe do të përmirësojë aksesin në financimin e aktiviteteve bujqësore;</li> <li>▪ Sjellja e bujqësisë parësore në pjesën formale të ekonomisë;</li> <li>▪ Zgjerimi i klimës së përgjithshme të biznesit në sektor për tërheqjen e FDI-ve;</li> </ul>
<b>Prodhimet dhe shërbimet (M&amp;S)</b>		
Mesatare	Mesatare	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Rritja e reformave të mëtejshme që synojnë uljen e numrit të procedurave dhe kohën për të nisur një biznes, si dhe shtrirja e të drejtave të pronësisë;</li> <li>▪ Mbështetje për zhvillimin e aftësive të orientuara drejt tregut, qeverisjes së korporatave dhe standardeve menaxheriale, në veçanti për SME-të;</li> <li>▪ Promovimi i investimeve të mëtejshme në shërbimet në infrastrukturë për të tërhequr FDI në sektor.</li> </ul>
<b>Pasuritë e patundshme</b>		
E madhe	Mesatare	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Harmonizimi i burokracisë lidhur me pronat e patundshme dhe përmirësimi i zbatimit të rregulloreve ekzistuese;</li> <li>▪ Rritja e vëmendjes në teknika dhe teknologji moderne të ndërtimit, përfshirë dhe eficientë në energji dhe qëndrueshmërinë;</li> <li>▪ Rritje e furnizimit me prona moderne tregtare në të gjithë nën segmentet;</li> </ul>
<b>Informacioni &amp; Teknologjitë e Komunikimit (ICT)</b>		
Mesatare	Mesatare	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zhvillim i mëtejshëm i infrastrukturës së telekomunikacioneve (interneti me brez të gjerë)</li> <li>▪ Rritje e mëtejshme e konkurrencës në segmentin e shtrimit të kabllave;</li> <li>▪ Rritje e mëtejshme e pavarësisë dhe kapacitetit rregullator të telekomunikacioneve; dhe</li> <li>▪ Përfundimin e harmonizimit të kuadrit rregullator me BE-në (veçanërisht zbatimi i kuadrit)</li> </ul>



Struktura e tregut	Institucionet e tregut	Sfidat kyçe
<b>BURIME ENERGETIKE DHE TË QËNDRUESHME</b>		
<b>Burimet natyrore</b>		
Mesatare	Mesatare	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përfundimi i procesit të privatizimit të Albpetrol-it në mënyrë transparente, ndërsa sigurohet qeverisja e duhur e korporatave, si dhe performanca operationale dhe financiare;</li> <li>▪ Mbështetje për hyrjen e lojtarëve të tjerë privatë dhe ndërkombëtarë në sektorin e prodhimit të naftës dhe gazit;</li> <li>▪ Mbështetje për zhvillimin e një tregu funksional gazi dhe miratimi i legjislacionit të nevojshëm dytësor;</li> <li>▪ Rritja e standardeve (mjedisore, shëndetësore, të sigurisë, transparenca, etj.) në industrinë e minierave.</li> <li>▪ Përforcimi i transparencës dhe llogaridhënës fiskale, përmirësimi i mbledhjes së tatimeve dhe të ardhurave;</li> </ul>
<b>Energjia</b>		
E madhe	Mesatare	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Rritja e konkurrencës nga sektori privat si në prodhim dhe në furnizimin me pakicë të energjisë;</li> <li>▪ Forcimi i pavarësisë të rregullatorit;</li> <li>▪ Përmirësimi i arkëtimeve dhe forcimi i disiplinës së pagimit në sektor;</li> <li>▪ Prezantimi i tarifave që reflektojnë koston për konsumatorët fundorë;</li> </ul>
<b>Energjia e qëndrueshme</b>		
Mesatare	Mesatare	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zbatimi i disiplinës së pagimit ndërmjet konsumatorëve, në mënyrë që tarifat e energjisë elektrike të bëhen një sinjal i kuptimtë që nxit investimet në efikasitetin e energjisë dhe energjinë e rinovueshme;</li> <li>▪ Finalizimi dhe zbatimi i ligjeve të shumëpritura për sektorin e energjisë, energjinë e rinovueshme dhe për efikasitetin e energjisë në përputhje me politikat e BE-së;</li> <li>▪ Vendosja e një tarife stabile për prodhuesit hidrocentrale të vegjël;</li> <li>▪ Forcimi i kapacitetit të rregullatorit.</li> </ul>
<b>Eficienta e ujit</b>		
E madhe	E madhe	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përmirësimi i kapacitetit institucional dhe koordinimit;</li> <li>▪ Dhënia e fondeve për objektivat e menaxhimit të ujit;</li> <li>▪ Rritja e tarifave të nxjerrjes drejt rekuperimit të koston;</li> <li>▪ Monitorimi dhe përcaktimi i çmimit për nxjerrjen industriale nga uji nëntokësor</li> <li>▪ Prezantimi i tarifave të ujit të ndotur bazuar në ngarkesë.</li> </ul>
<b>Eficienta e materialeve</b>		

<b>Struktura e tregut</b>	<b>Institucionet e tregut</b>	<b>Sfidat kyçe</b>
E madhe	E madhe	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dhënia e fondeve për projektet për parësore në strategji dhe përmirësimi i ekspertizës institucionale dhe koordinimit; zëvendësimi i pikave in formale të grumbullimit të mbetjeve dhe i vend depozitimeve të pakontrolluara nga vend-depozitive rajonale të kontrolluara;</li> <li>▪ Rritja dhe zbatimi i tarifave që arrijnë të mbulojnë kostot për vend depozitimet e mbetjeve;</li> <li>▪ Zgjerimi i zonës së mbulimit me mbledhje të mbetjeve;</li> <li>▪ Krijimi i mbledhjes së të dhënave dhe monitorimi për mbetje industriale.</li> </ul>
<b>INFRASTRUKTURA</b>		
<b>Uji dhe kanalizimet</b>		
E madhe	Të mëdha	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Reforma tarifore;</li> <li>▪ Komercializimi i ndërmarrjeve të shërbimeve publike;</li> <li>▪ Prezantimi i një kuadri të përshtatshëm rregullator;</li> <li>▪ Përmirësim i autonomisë financiare të bashkive dhe i ndërmarrjeve bashkiake nën një kuadër rregullator efektiv.</li> </ul>
<b>Transporti urban</b>		
Mesatare	Të mëdha	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zgjidhje më të mira dhe më të integruara për transportin urban;</li> <li>▪ Reformat e biletave;</li> <li>▪ Forcimi i kontratave të shërbimit</li> <li>▪ Zgjerim i procedurave të tenderimit të rrugëve</li> </ul>
<b>Rrugët</b>		
Mesatare	Mesatare	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Prezantim i procedurave të tenderimit dhe kontraktim i plotë në sektorin privat i mirëmbajtjes rutinë të rrugëve kombëtare;</li> <li>▪ Prezantimi i kontratave të mirëmbajtjes të mbështetura në performancë;</li> <li>▪ Zhvillimi i mekanizmave për financimin rrugor;</li> <li>▪ Prezantimi i një marrëveshje në nivel shërbimi ndërmjet qeverisë dhe ARRSH-së (pasuese e GRD-së) me përgjegjësi dhe detyrime të përcaktuara;</li> <li>▪ Hartimi i një strategjie PPP-je dhe zhvillimi projekti;</li> </ul>

<b>Struktura e tregut</b>	<b>Institucionet e tregut</b>	<b>Sfidat kyçe</b>
<b>Hekurudhat</b>		
E Madhe	Të mëdha	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Rritja e transparencës financiare dhe pavarësisë nga qeveria;</li> <li>▪ Krijimi i qëndrueshmërisë financiare në aktivitetet e pasagjerëve dhe infrastrukturës (përfshirë reformën tarifore dhe reformën e mekanizmit të PSO-së);</li> <li>▪ Lidhje më të mira të rrjetit hekurudhor në planin e rrjetit TENS dhe përparësive për financim;</li> <li>▪ Prezantimi i konkurrencës në biznesin e hekurudhave</li> </ul>
<b>INSTITUCIONET FINANCIARE</b>		
<b>Bankimi</b>		
Mesatare	Mesatare	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ulja e normës së huave të këqija;</li> <li>▪ Përmirësimi i raportit depozita/PBB;</li> <li>▪ Rritje e përqindjes së huadhënies në monedhë vendase ndaj totalit të huadhënies;</li> </ul>
<b>Sigurimet dhe shërbimet e tjera financiare</b>		
E madhe	Mesatare	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Rritja e penetrimit të sigurimeve;</li> <li>▪ Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve të sigurimeve;</li> <li>▪ Forcimi i standardeve të kontabilitetit, raportimit dhe auditimit të kompanive të sigurimeve;</li> <li>▪ Rritje e penetrimit të lizingut;</li> <li>▪ Zhvillim i mëtejshëm i tregut vullnetar të pensioneve;</li> </ul>
<b>Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme</b>		
Mesatare	Mesatare	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zgjerimi i aksesit në financim përmes instrumenteve të disponueshme financiare për SME-të, si për shembull aksesin në lizing dhe disponueshmëria e kapitalit aksionar;</li> <li>▪ Përmirësim i vazhdueshëm i mbulimit të sistemit të informacionit të kreditive;</li> <li>▪ Shtrirja e zbatimit efektiv të të drejtave të kreditorëve;</li> </ul>
<b>Kapitali privat</b>		
I madh	Të Mëdha	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Krijimi i kushteve më të mira për zhvillimin e kapitalit privat në Shqipëri;</li> <li>▪ Përmirësimi i qeverisjes së korporatave, transparencës dhe praktikave të biznesit;</li> <li>▪ Zhvillimi i një baze lokale investitorësh institucionalë;</li> </ul>
<b>Tregjet kapitale</b>		
I madh	Të mëdha	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zhvillimi i një tregu kapital lokal;</li> <li>▪ Mbështetje e progresit për privatizimet;</li> </ul>

VLERËSIMET E HENDEKUT TË PËRFSHIRJES<sup>10</sup> EKONOMIKE – SHQIPËRI

Përfshirja ekonomike		
Dimensioni i hendekut të përfshirjes	Hendeku i përfshirjes	Sfidat kyçe
<b>Rinia</b>		
Mundësitë për rininë	I madh	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përmirësimi i progresit të rrugëve drejt punësimit për të rinjtë duke prezantuar mundësi efektive të të mësuarit gjatë punës në partneritet me shkollat dhe universitetet lokale;</li> <li>▪ Përmirësim i mundësive për punësim dhe trajnim për të rinjtë në zona me shërbim të ulët, si dhe kontakte specifike me të diplomuarit.</li> </ul>
Cilësia e arsimit	Mesatar	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Forcimi i angazhimit të sektorit privat me autoritetet arsimore për përmirësimin e procesit arsimor (në veçanti AFP-në dhe arsimin universitar) për të siguruar që aftësitë e të rinjve që hyjnë në tregun e punës i përmbushin kërkesat e tregut lokal të punës.</li> </ul>
Struktura e tregut të punës	Mesatar	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Mbështetje e qeverisë në zhvillimin e programeve për politikën për të rinjtë dhe iniciativave për të trajtuar çështje strukturore të papunësisë në vend për një treg pune më fleksibël;</li> <li>▪ Stimulimi i punëdhënësve për përmirësimin e aksesit për punësim për të rinjtë, veçanërisht në rajonet më pak të zhvilluara për të trajtuar migracionin e brendshëm dhe të jashtëm të të rinjve.</li> </ul>
<b>Gjinia</b>		
Praktikat e punës	I madh	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Motivimi i klientëve për përmirësimin e politikave të burimeve njerëzore lidhur me praktikat e barabarta të punësimit, duke përfshirë praktika të barabarta pagimi, akses në kujdesin ndaj fëmijëve dhe praktika mos-diskriminimi për përmirësimin e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës;</li> </ul>
Punësimi dhe pronësia e firmave	I madh	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përmirësim i nivelit të regjistrimit të grave dhe të diplomuarve në programet arsimore të STEM (shkencë, teknologji, inxhinieri dhe prodhim) nëpërmjet programeve të synuara të kontaktimit, përmirësimin e udhëzimeve për karrierë dhe partneriteteve me klientë të sektorit privatë;</li> <li>▪ Përmirësimi i aksesit në programet e lidhshme për gratë për të përmirësuar rrugëtimin e tyre drejt pozicioneve menaxheriale.</li> </ul>

<sup>10</sup> Hendeqet e Përfshirjes Ekonomike të BERZH-it kategorizojnë institucionet, tregjet, dhe sistemet arsimore të të gjitha shteteve ku është i pranishëm e BERZH-i lidhur me kapacitetin për zgjerimin e mundësisë ekonomike për individët, pavarësisht gjinisë, moshës ose vendit të tyre të lindjes. Këto hendeqe masin *diferencat* në mundësi – ndërmjet 15 - 24-vjeçarëve dhe punonjësve më të mëdhenj, dhe ndërmjet grave e burrave e jo *nivelet* e mundësive. Hendeqet raportohen në këtë Strategji për Vendlindjen kur ekziston një hendek përfshirjeje mbi vlerësimin “i vogël”. Këto hendeqe janë në përputhje me përditësimin e Hendekut të Përfshirjes së BERZH-it 2014.

Aksesi në financa	I madh	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përmirësim i aksesit në financa për gratë për të përcaktuar se ku aksesi në koletaral përbën pengesa për gratë sipërmarrëse për të filluar ose rritur bizneset e tyre.</li> <li>▪ Identifikimi i dështimeve themelore në treg dhe mbështetje e sektorit bankar për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja për SME që drejtohen nga gratë, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në, mbështetjen e biznesit dhe të ekspertizës për sipërmarrëset gra dhe SME-të.</li> </ul>
Shërbimet shëndetësore	Mesatar	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Mbështetje e aksesit më të mirë dhe e cilësisë më të mirë të kujdesit shëndetësor për gratë (veçanërisht për përmirësimin e vdekshmërisë së nënave).</li> </ul>
<b>Rajonet</b>		
Tregjet e punës	I madh	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Rritje e investimeve në zonat me nivel të ulët shërbimesh të Shqipërisë për të përmirësuar aksesin në mundësitë cilësore të punësimit në këto zona.</li> <li>▪ Promovimi i integritit rajonal, duke përmirësuar aksesin në trajnime cilësore dhe mundësi mësimi nëpërmjet punës nga popullsia e veriut në nivelin e zonave të qyteteve urbane.</li> </ul>
Aksesi në shërbime	Mesatar	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përmirësim i infrastrukturave rajonale, i aksesit në veçanti tek uji në zonat rurale malore shqiptare.</li> <li>▪ Përmirësim i përfshirjes financiare me vëmendje të veçantë tek popullsia rurale në pjesë më pak të zhvilluara të vendit.</li> </ul>
Institucionet	Mesatar	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Mbështetje për prezantimin e një kuadri institucional efektiv transparent për tërheqjen e FDI-ve dhe krijimin e një mjedisi nxitës biznesi për rritjen e mundësive për krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin rural.</li> </ul>

## SHTOJCA 4 – TRANZICIONI LIGJOR

### Hyrje

Në këtë shtojcë jepet një analizë kritike mbi tema të caktuara ligjore të lidhura me strategjinë e investimeve të Bankës në Shqipëri gjatë periudhës në vijim. Analiza bazohet tek vlerësimet e ligjeve tregtare të kryer nga Programi për Tranzicionin Ligjor<sup>11</sup> i BERZH-it. Për lehtësi reference, analiza ndjek orientimet kryesore strategjike të përcaktuara në këtë strategji të vendit, në veçanti mbështetur në masat e propozuara në seksionin ‘Dialogu i politikave dhe ndihma teknike’.

### **Tema 1: Mbështetje për konkurrueshmërinë e sektorit privat duke nxitur krijimin e vlerave, lehtësuar aksesin në financë dhe forcuar një mjedis mundësues biznesi**

#### *Kapaciteti gjyqësor në sektorin tregtar*

Shqipëria mori statusin e vendit kandidat më 24 qershor 2014,<sup>12</sup> gjë që tregon për zhvillime pozitive, si dhe për një gatishmëri të madhe politike dhe potencial për të çuar më përpara reformat. Raporti i progresit i Komisionit Evropian për reformën në drejtësi dhe luftën kundër korrupsionit,<sup>13</sup> i cili parapriu vendimin për dhënin e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë, nënvizonte zhvillime pozitive në fushën e parandalimit dhe luftës së korrupsionit, përfshirë reformat strukturore dhe legjislative. Më tej, po bëhen përpjekje për të ulur çështjet e prapambetura dhe ngarkesën e punës në gjykata; ndryshime legjislative që synojnë të përmirësojnë efikasitetin në drejtësi janë në proces e sipër. Gjithashtu, janë bërë ndryshime të procedurave që rregullojnë imunitetin gjyqësor për të siguruar llogaridhënien e gjyqtarëve. Aktualisht, po përgatitet një strategji e re reformash në gjyqësor për periudhën 2015-2020 me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë, të tillë si Komisioni i Venecias.

Mangësitë vijojnë ende, dhe sistemi gjyqësor mbetet një ndër fushat me përparësi për reforma të mëtejshme në kuadrin e vendit kandidat për në BE. Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të siguruar pavarësinë dhe llogaridhënien e gjyqësorit, paralelisht me masat për përmirësimin e efikasitetit në drejtësi. Kompetencat e Presidentit lidhur me emërimin e gjyqtarëve të gjykatave më të larta ngrenë çështje që lidhen me politizimin e gjyqësorit, gjë e cila mund të duket e pazgjdhshme pa ndryshimet kushtetuese. Ndryshimet e fundit në ligjin "Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë", që trajtuan kryesisht arsyet për pezullimin dhe shkarkimin e anëtarëve të tij, rezultuan të ishin me natyrë të kufizuar, megjithëse synimi ishte që ato të përmirësojnë punën e këtij organi. Gjykatat administrative për të cilat raportohet se nuk kanë staf të plotë, duhet të vihen plotësisht në punë. Në sistemin gjyqësor duhet të inkurajohet edhe përdorimi më i madh i teknologjisë së informacionit, duke përfshirë dhe mirëmbajtjen e përshtatshme të Qendrës për Dokumentacionin Gjyqësor. Nevojiten përmirësime të mëtejshme për të siguruar emërimin, promovimin dhe transferimin transparent të gjyqtarëve,<sup>14</sup> përmirësim të kuadrit rregullator për përmbaruesit privatë dhe promovimin e metodave alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve (p.sh., arbitrazh).

<sup>11</sup> Shih [www.ebrd.com/law](http://www.ebrd.com/law)

<sup>12</sup> [http://europeanmovement.eu/wp-content/uploads/2014/08/EC-Enlargement-Strategy\\_Summary\\_August-2014\\_Final-version.pdf](http://europeanmovement.eu/wp-content/uploads/2014/08/EC-Enlargement-Strategy_Summary_August-2014_Final-version.pdf)

<sup>13</sup> [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/al\\_report\\_june\\_2014.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/al_report_june_2014.pdf)

<sup>14</sup> [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-albania-progress-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-albania-progress-report_en.pdf)

*Transaksione e kolateralizuara (pronat e tundshme dhe të patundshme)*

Hipoteka mbi asetet e patundshme (hipotekimi) mbulohet nga Kodi Civil (neni 560-607). Në mënyrë që një hipotekë të jetë e vlefshme, ajo duhet të krijohet me anë të një instrumenti të shkruar të noterizuar dhe duhet të regjistrohet në zyrën përkatëse të regjistrimit të pasurive së patundshme. Procesi i regjistrimit është përgjithësisht i ngadaltë. Për më tepër, profesionistët lokalë raportojnë që titulli ekzistues i pronësisë nuk mund të përcaktohet me siguri të mjaftueshme dhe që në këtë kuadër ka pasur një numër të konsiderueshëm ankesash që kanë treguar që titulli i hipotekuesit nuk është i sigurt deri në masën e nevojshme dhe është bërë objekt i pretendimeve kundërshtuese mbi titullin. Një pjesë e mirë e pretendimeve për kthim janë ende pezull, megjithëse pretendimet për kthim lidhen zakonisht me pronën që zotërohet ende nga shteti.

Barra mbi pronat e tundshme mbulohet nga Ligji për Barrën Siguruese. Regjimi i krijuar reflekton pjesën më të madhe të parimeve moderne të transaksioneve të siguruar. Ai parashikon që mund të vihet një barrë mbi pronat e tundshme ose të patundshme, aktualisht ose në të ardhmen, si sigurim për një ose më shumë detyrime aktuale, ose detyrime që mund të dalin në të ardhmen për bartësin e barrës, ose një palë të tretë. Detyrimi i siguruar mund të jetë i kushtëzuar dhe nuk nevojitet të jetë detyrim monetar, por duhet të jetë i aftë që të vlerësohet në mjete monetare. Në përgjithësi ligji është i qartë, gjithëpërfshirës dhe ofron fleksibilitetin e duhur për t'ju përgjigjur transaksioneve relativisht të sofistikuara. Një mangësi e ligjit lidhet me përparësinë e kreditorëve të siguruar, pasi përparësia mund të humbasë kundrejt ndonjë punonjësi, sigurimi shoqëror apo pretendimeve shtetërore.

Pika më e dobët e një sistemi me transaksion të siguruar qëndron tek zbatimi, veçanërisht ku bëhet fjalë për hipotekat. Dispozitat ligjore të Ligjit për Barrën Siguruese synojnë të japin një sistem të shpejtë dhe eficient duke u dhënë të drejta automatike kreditorëve të siguruar për të filluar një procedurë përmbarimi në rast mospagimi nga ana e debitorit (klauzola e ekzekutimit) duke përdorur përmbarues dhe mundësinë e zgjedhjes ndërmjet përmbaruesve privatë ose shtetërorë. Megjithatë, përmbaruesit nuk kanë rezultuar të jenë aq të besueshëm dhe eficientë sa nevojitej. Edhe gjykatat raportohen të jenë të ngadalta dhe jo me shumë eksperiencë në trajtimin e çështjeve të përmbarimit. Problemi qëndron tek dispozitat e përmbarimit të Kodit të Procedurës Civile dhe lidhen me numrin e kufizuar të ankandëve të disponueshme, periudhat kohore të paspecifikuara për përmbaruesin që ai të njoftojë debitorin lidhur me procesin që zvarritet, dhe mungesën e standardeve të përgjithshme për vlerësimin e pasurive të patundshme.

*Qeverisja e korporatave*

Në Progres Raportin e vitit 2014 për Shqipërisë, Komisioni Evropian deklaronte se<sup>15</sup> “është bërë ca progres në fushën e të drejtës për shoqëritë tregtare përmes miratimit të standardeve të reja kombëtare të kontabilitetit. Duhet punë më e madhe për të rritur kapacitetet e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe të Organit të Auditit Publik. Duhet të sigurohet pavarësia e këtij institucioni. Shqipëria do të duhet të përqendrohet tek zbatimi i standardeve të kontabilitetit dhe të auditimit dhe të rrisë më tej kapacitetin e inspektimit si pjesë të punës së saj për ndërtimin e qeverisjes së shëndoshë të ekonomike. Legjislacioni duhet të përafrohet më tej me *acquis-in*, në veçanti për auditimin.”

<sup>15</sup> Shih Kreun 6: Ligji për Shoqëritë Tregtare.

Raporti i Progresit i BE-së sheh përafrimin e legjislacionit kombëtar me Acquis, i cili nuk është shterues mbi qeverisjen e korporatave. Vlerësimi më i fundit i BERZH-it sheh legjislacionin dhe praktikën e qeverisjes së korporatave të kompanive dhe nënvizon një kuadër goxha më poshtë standardeve ndërkombëtare në fushat nën shqyrtim.

Kur shihet *struktura dhe funksionimi i bordit*, ligji dhe Kodi kërkojnë që bordet të kenë shumicën të përbërë nga drejtorë të pavarur, megjithatë përkufizimi i "të pavarur" është i pjesshëm dhe i paqartë. Kur shihen bordet e kompanive më të mëdha, rezultojnë që vetëm një kompani pohon se ka një (dhe vetëm një) anëtar të pavarur bordi. Megjithatë, ky person është ish Drejtor i Përgjithshëm i kompanisë, kështu që kemi dyshime mbi pavarësinë e tij. Kur shihen kompetencat dhe përgjegjësitë e bordit, rezultojnë që sipas ligjit, e drejta për të emëruar drejtorët ekzekutivë në sistemin me dy nivele i takon aksionerëve. Kjo e pengon bordin mbikëqyrës të ketë ndikim efektiv mbi ekzekutivët, duke kufizuar kështu funksionet e tij mbikëqyrëse. Po ta kthejmë vëmendjen tek *transparenca dhe raportimi*, ligji u kërkon kompanive të botojnë raportet vjetore, të cilat duhet të trajtojnë "*elementët kyç të rregullave të qeverisjes së korporatës (...), profilin e drejtorëve menaxhues dhe të anëtarëve të bordit dhe të shpjegojnë pse drejtorët individualë ose supervizorët kualifikohen të shërbejnë në kuadrin e këtij profili*". Megjithatë, nuk ka sanksione në rast se kompanitë e shkelin këtë rregull. Në fakt, vetëm 5 nga 10 kompanitë më të mëdha në vend i botojnë raportet vjetore, vetëm dy prej tyre i botojnë emrat e anëtarëve të bordit dhe askush prej tyre nuk i jep kualifikimet e tyre. Kur shohim *kontrollin e brendshëm*, ligji u rekomandon shoqërive aksionare të "*krijojnë komitete të përbëra nga anëtarët e tyre për të përgatitur mbledhjet dhe vendimet e tyre, ose të mbikëqyrin zbatimin e vendimeve të tyre, në veçanti (...) kontrollin e kontabilitetit të performancës së kompanisë*". Ligji rekomandon më tej se "*shumica e çdo komiteti duhet të përbëhet nga drejtorë jo-menaxhues të pavarur*". Në praktikë vetëm bankat duket se kanë një komitet auditimi, siç kërkohet nga ligji "Për Bankat", por duket se ai që quhet "komitet auditimi" në praktikë është një organ këshillimor, jo një komitet me bord. Kjo për shkak të faktit që komiteti jo domosdoshmërisht përbëhet nga anëtarë të bordit. Kjo praktikë ka rezultuar jo e suksesshme dhe duhet të rishqyrtohet. Së pari, është e rëndësishme që komiteti i auditit të përfshijë vetëm anëtarë jo ekzekutivë (të pavarur) të bordit, në rast se funksionet që i delegohen komitetit të auditimit janë funksione tipike bordi. Së dyti, është e domosdoshme që këta anëtarë të përfaqësojnë në komitetin e auditimit dhe që rekomandojnë një masë të caktuar, të ndjekin zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe të votojnë për këto rekomandime në bord, duke përforcuar kështu pozicionin e tyre dhe "grykimin objektiv të bordit". Së fundi, komitetet e auditimit, përfshirë dhe personat nga jashtë, mund të krijojnë probleme me çështjet e konfidencialitetit dhe të llogaridhënies, pasi persona të tillë "të jashtëm" mund të mos të jenë të detyruar të respektojnë parimet e besnikërisë apo kujdesit që kërkohet për anëtarët e bordit.

## **Tema 2: Zgjerimi i tregjeve duke forcuar lidhjet rajonale**

### *Sektori energjetik*

Shqipëria ka bërë progres në sjelljen e kuadrit të saj ligjor dhe rregullator në sektorin energjetik në përputhje me *acquis*-in e BE-së, megjithatë ende nevojiten reforma të mëtejshme. Sigurimi i energjisë mbetet çështje kritike për vendin. Një pjesë e mirë e energjisë importohet. Sipas Sondazhit të fundit të Performancës së Mjedisit të Biznesit dhe Ndërmarrjeve (BEEPS), furnizimi i shtrenjtë ose jo i besueshëm me energji elektrike është shqetësim kyç për kompanitë shqiptare. Ndërkohë që numri i ndërprerjeve të energjisë elektrike ka rënë ndjeshëm në periudhën 2007 - 2014 (kryesisht për shkak të shtimit të sasisë së reshjeve), sasia e ndërprerjeve është ende më lartë se mesatarja e Evropës Juglindore.



Fatura e papaguara të energjisë dhe pozicioni i cënueshëm i kompanive që operojnë në fushën e energjisë kontribuojnë në paqëndrueshmërinë e përgjithshme të sektorit.

Në prill të 2015-ës, Parlamenti miratoi Ligjin "Për Energjinë Elektrike" duke transpozuar Paketën e Tretë për Energjisë. Në të njëjtën kohë, Ligji "Për Sektorin Energjetik", i miratuar në 2003-in, kërkon përafrim të mëtejshëm me *acquis-in* e BE-së. Duhet të zbatohet veçanërisht kërkesa për ndarjen (aktualisht, sistemi i operatorit të transmetimit është veçuar, por operatori i sistemit të shpërndarjes (me pakicë) nuk është veçuar). Aksesit i detyrueshëm i palëve të treta dhe trajtimi i refuzimeve dhe apelimeve duhet të mbulohet nga ligjet bazë. Për sa i përket tregut të gazit, ndërsa kuadri aktual ligjor përgjithësisht e lejon zhvillimin e infrastrukturës së gazit natyror, Ligji "Për Gazin Natyror", i miratuar në vitin 2008, duhet të përditësore për të lejuar transpozimin e plotë të Paketës së Tretë për Energjinë. Në veçanti, kërkesa për ndarjen dhe rregullat e aksesit për palët e treta duhet të specifikohen më tej në përputhje me *acquis-in* e BE-së. Teksti i projektligjit për sektorin e gazit natyror që ndryshon ligjin ekzistues të 2008-ës është i përafruar me *acquis-in*. Ky projekt është miratuar më 22 korrik të 2015 nga Këshilli i Ministrave dhe i është dërguar Parlamentit për miratim.

### *Energjia e rinovueshme*

Shqipëria ka burime energjie diellore, ere dhe biomase. Miratimi i ligjit "Për energjinë e rinovueshme" në vitin 2013 dha sinjalin e angazhimit për të përmirësuar rregullimin e burimeve të rinovueshme të energjisë në vend (RES). Megjithatë, pezullimi i zbatimit dhe efektivitetit të plotë të tij është një hap prapa. Vendi duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të siguruar harmonizimin me *acquis-in* e BE-së dhe zbatimi i legjislacionit mbetet ende një sfidë e rëndësishme. Transparenca lidhur me lidhjen dhe aksesin në rrjet është një çështje e rëndësishme dhe aktualisht nuk ekziston sistemi i certifikatës së origjinës. Ndërsa ligji i ri parashikon akses në rrjet me përparësi për prodhuesit e energjisë së rinovueshme, zbatimi i tij është ende pezull. Skema kryesore e mbështetjes për burimet e energjisë së rinovueshme vjen nga tarifat e prodhuesve privatë, të cilat aktualisht aplikohen vetëm për hidrocentralet e vogla mbështetur në marrëveshjet e koncesionit të nënshkruara për 15 vjet. Shqipëria, ndonëse me vonesë, po zhvillon planin e parë kombëtar të masave për energjinë e rinovueshme dhe përgatitja e tij mbetet sfidë për qeverinë.

### *Eficienta energjetike*

Intensiteti energjetik i ekonomisë shqiptare mbetet relativisht i lartë krahasuar me shtetet anëtare të BE-së, por më i ulët sesa i vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor. Sektori rezidencial është përdoruesi fundor më i madh i energjisë dhe përbën thuajse gjysmën e konsumit të enegjisë elektrike. Ligji "Për Eficencën e Energjisë" i vitit 2005 është baza e kuadrit ligjor dhe rregullator në sektor. Megjithatë ai është i vjetruar dhe jo në përputhje me *acquis-in* e BE-së. Një projekt-ligj i ri "Për eficientën e Energjisë", përgjithësisht në përputhje me *acquis-in*, është duke u përgatitur me mbështetjen e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Plani i Parë Kombëtar për Eficencën Energjetike (EEAP) është miratuar në vitin 2011, duke përcaktuar një objektiv kombëtar indikativ për kursimin e energjisë prej 168 Ktoe deri në vitin 2018 (9 përqind). Pengesat kryesore për rritjen e eficientës së energjisë të identifikuar nga EEAP-ja e parë dhe që duhet të trajtohen nga politika dhe rregullore kombëtare përfshijnë mos zbatimi i ligjit për energjinë, mungesa e fondeve të synuara vetëm për eficientën energjetike, mungesa e akteve nën-ligjore dhe mungesa e tregut të shërbimeve të energjisë. EEAP-ja e dytë nuk është miratuar brenda afateve kohore të përcaktuara. Përgatitja e këtij dokumenti duhet të jetë përparësi kryesore për qeverinë.

Në sektorin e ndërtimeve, legjislacioni aktual përqendrohet tek ligji për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa, i vitit 2002. Ligji në përgjithësi është i vjetërsuar dhe ndërsa kërkon që të gjitha

ndërtesat të përmbushin kërkesat për ruajtjen e nxehtësisë, ai nuk zbatohet siç duhet. Një ligj i ri për eficientë e energjisë në ndërtesa, i cili ka transpozuar Direktivën e Ndërtesave të BE-së 2010/31/BE, që është përgjithësisht në përputhje me *acquis*-in, është duke u përgatitur me mbështetjen e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Aktualisht ai është në pritje të miratimit nga qeveria. Kërkesat për etiketimin e produkteve të konsumit të energjisë po përcaktohen në ligjin “Për Informimin mbi Konsumin e Energjisë dhe Burimeve të Tjera të Lidhura me Energjinë”, i cili transponon Direktivën 2010/30/BE. Megjithatë, legjislacionit i mungojnë rregulloret përkatëse mbështetëse.

### **Tema 3: Promovimi i qëndrueshmërisë së ndërmarrjeve të shërbimeve publike përmes komercializimit dhe pjesëmarrjes së sektorit privat**

#### *Koncesionet dhe partneritetet publike-private*

Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetet publike-private” (ligji i “PPP-ve”) është instrumenti kryesor ligjor që rregullon PPP-të dhe koncesionet. Ai është ligj i kohëve të fundit dhe duhet ende kohë për të parë nëse ai do të funksionojë apo jo.

Agjencia për Trajtimin e Koncesioneve (ATRAKO),<sup>16</sup> e ngarkuar për t'u ardhur në ndihmë autoriteteve kontraktuese gjatë të gjithë ciklit të projektit, Agjencia e Prokurimeve Publike (“APP-ja”),<sup>17</sup> e ngarkuar me monitorimin e zbatimit të procedurave të koncesioneve/PPP-ve për të siguruar transparencën dhe eficientë e tyre, dhe Ministria e Financave janë tre subjektet e përfshira në zbatimin e projekteve koncesionare/të PPP-ve.<sup>18</sup>

Ligji i PPP-ve është një dokument i plotë, duke përfshirë të gjitha dimensionet kryesore të pritshme nga ligje të ngjashme përfshirë përkufizimet, objektin, përzgjedhjen, kontratat dhe madje mbështetjen financiare dhe interesat e kolateraleve. Ligji i PPP-ve zbatohet mbi një gamë të gjerë sektorësh, siç specifikohet në nenin 4 të tij, duke përfshirë dhe ato sektorë të cilët zakonisht nuk listohen për aplikim për PPP, si për shembull telekomunikacioni ose minierat. Dhënia e koncesioneve mund të apelohej së pari në nivelin administrativ dhe më pas mund të dërgohet në gjykatë. Mosmarrëveshjet me objekt një kontratë koncesioni mund të zgjidhen nga një arbitrazh ndërkombëtar.

Megjithëse një dokument i kohëve të fundit, ligji për PPP-të u rishikua nga Parlamenti në korrik të 2015-ës. Më tej, autoritetet thuhet që janë të gatshme të hartojnë akte nënligjore, udhëzime, formularë dhe metodologji me synimin e ofrimit të ndihmës praktike, në veçanti për bashkitë, për tërheqjen e investimeve private për projekte dhe shërbime të infrastrukturës publike. Zhvillimet institucionale dhe rregullatore, si dhe harmonizimi i mëtejshëm me rregullat e BE-së janë përmendur mes objektivave në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike të Ministrisë së Financave për periudhën 2014-2020. Me shpresë, përpjekjet e sipërcituara do të çojnë në ushtrimin e një qasje gjithëpërfshirëse, duke mundësuar kështu cilësinë, përdorimin e standardeve më të mira moderne dhe shoqërohen me masa të tjera për zhvillimin e kapaciteteve.

<sup>16</sup> <http://www.ekonomia.gov.al/en/the-ministry/dependency-institutions/concession-treatment-agency-atrako>

<sup>17</sup> <https://www.app.gov.al/ep/default.aspx>

<sup>18</sup>

[http://www.eib.org/epec/resources/publications/epec\\_wbif\\_overview\\_ppp\\_institutional\\_arrangements\\_institutional\\_frameworks](http://www.eib.org/epec/resources/publications/epec_wbif_overview_ppp_institutional_arrangements_institutional_frameworks)

## SHTOJCA 5 – PROFILI GJINOR

### *Pjesëmarrja e tregut të punës dhe hendeku i pagesës gjinore*

Sipas Institutit të Statistikave të Republikës së Shqipërisë, gratë nga 15 vjeç e sipër në Shqipëri kanë një nivel pjesëmarrje në tregun e punës shumë më të ulët sesa burrat (44 përqind përkundrajt 65.5 përqind). 37.6 përqind e grave dhe 51.4 përqind e burrave janë të punësuar. Gratë nga komuniteti rom dhe egjiptian janë shpesh të disavantazuara si për faktin që janë gra, dhe për faktin që vijnë nga grupe pakicash.

Gratë fitojë mesatarisht 10 përqind më pak se burrat. Hendeku i pagave ndryshon ndërmjet llojeve dhe kategorive të ndryshme të punëve dhe është më i ulët ndërmjet punonjësve me aftësitë më të larta dhe më i lartë ndërmjet punonjësve me aftësi më të kufizuara. Hendeku i pagesës gjinore zgjerohet me moshën, duke reflektuar faktin që gratë kanë më pak të ngjarë se burrat që të bëjnë progres në pozicione drejtuese.

Gratë që hyjnë në tregun e punës kufizohen nga gama e ngushtë e profesioneve dhe sektorëve të punësimit të cilat konsiderohen si të pranueshme ose të dëshirueshme për gratë, ose për shkak të perceptimeve kulturore, ose për shkak të nevojës për të balancuar punën me përgjegjësitë familjare. Ka nivele të larta të segregimit horizontal në tregun e punës në Shqipëri. Pjesa më e madhe e grave në punësim përqendrohen tek sektorët më pak të paguar, kryesisht në bujqësi, arsim, shëndetësi dhe punë sociale, ndërsa burrat kanë tendencë të punësohen në sektorë të tillë si ndërtim, miniera dhe transport, të cilët përfaqësojnë dhe sektorët më mirë të paguar të ekonomisë. Segregimi i tregut të punës ndodh edhe për faktin që vajzat janë të mbi përfaqësuara në kurse të caktuara të arsimit të lartë, si shëndetësia dhe, arsimi, gjë e cila e kufizon më tej mundësinë e tyre për punësim. Ka edhe segregim vertikal, pasi më pak gra se burra janë të përfaqësuara në pozicione drejtuese. Për shembull, megjithëse gratë zënë pjesën më të madhe të punëve në sektorin publik, burrat kanë dy herë më shumë të ngjatë të kenë pozicione të larta në sektorin publik, në ligj-vënie ose në pozicione ekzekutive.

### *Sipërmarrja, aksesimi në financë*

Sipas Sondazhit të fundit të Performancës së Mjedisit të Biznesit dhe Ndërmarrjeve (BEEPS) të 2015-ës, 11.7 përqind e 360 firmave objekt i studimit, të pranishme në sektorin e prodhimit, shitjes me pakicë dhe shërbimeve të tjera në Shqipëri kishin një menaxhere grua të nivelit të lartë dhe 12.5 përqind të firmave kishin një grua në pronësi (nën mesataren e Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore me nivel mesatar përkatësisht prej 18.7 përqind dhe 30.9 përqind). Statistikat zyrtare tregojnë që gratë zotërojnë ose administrojnë vetëm 27 përqind të të gjitha ndërmarrjeve aktive në Shqipëri.

Ndërmarrjet e zotëruara ose të drejtuara nga gratë gjenden kryesisht në zonat urbane, të tilla si Tirana dhe Elbasani, janë më të vogla sesa ndërmarrjet që drejtohen nga burrat dhe përqendrohen në aktivitete me vlerë më të ulët, si tregti artikujsh bazë, shërbime dhe bujqësi. Në zonat rurale, gratë menaxhere dhe pronare firmash janë shumë të nën përfaqësuara. Për shembull, sipas Institutit të Statistikave, pavarësisht nga fakti që më shumë se gjysma e grave në zonat rurale punojnë në bujqësi, ato zotërojnë dhe menaxhojnë vetëm 6 përqind të fermave, duke e bërë bujqësinë sektorin me përqindjen më të ulët të ndërmarrjeve të menaxhuara nga gratë.

Sipas ligjit burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në financa në Shqipëri. Megjithatë ka pengesa të tërthorta që shpesh i parandalojnë sipërmarrëset gra të kenë akses në financim në të njëjtin nivel si edhe burrat. Kjo për shkak edhe të niveleve të ulëta të pronësisë së pasurive të patundshme nga ana e tyre, gjë që e bën të vështirë pasjen e kolateralit të nevojshëm për sigurimin e huave. Legjislacioni kërkon që toka të regjistrohet në emrin e kryefamiljarit, të cilët praktikisht janë zakonisht burra. Si rezultat, vetëm deri në 10 përqind e tokës vlerësohet të zotërohet prej grave. Pengesa të tjera me të cilat hasen gratë janë mosdija e zhvillimit të planeve të marketingut dhe të biznesit.

## SHTOJCA 6 – BERZH-I DHE KOMUNITETI DONATOR

Bashkëpunimi teknik i financuar nga donatorët (TC) në Shqipëri i ka lejuar Bankës të bëjë punë të hershme diagnostikuese, përfshirë studimet e fizibilitetit dhe përgatitjet për mundësitë e investimeve, ndërtimin e kapaciteteve të klientëve të mundshëm, dhe veçanërisht mbështetje për zbatim projekti në sektorin e infrastrukturës dhe ndarjen e eksperiencës së tranzicionit të politikë bërësve dhe partnerëve të sektorit privat nga vendet që operon BERZH-it në Evropën Qendrore dhe Lindore. Fondet për bashkëpunim teknik janë ofruar po ashtu për mbështetjen e transferimit të aftësive dhe rritjen e MSME-ve private vendase nëpërmjet një game programesh këshilluese investimesh dhe huadhënieje, duke përfshirë dhe Shërbimet Këshillimore për Biznesin, Programin për Rritjen e Ndërmarrjeve dhe Lehtësitë Kredituese për Ndërmarrjet Vendase, si edhe për mbështetjen e zhvillimit të mjedisit të biznesit nëpërmjet sponsorizimit të Sekretariatit të Këshillit të Investimeve.

Shqipëria ka përfituar po ashtu nga shumë grante jo në formën e ndihmës teknike, të ofruara në formën e granteve të investimeve për bajpase, rrugë lokale dhe rajonale, tarifa për stimuj performance në kuadrin e lehtësive të financimit rajonal, të tilla si Marrëveshja e Ballkanit Perëndimor për Financimin e Energjisë së Qëndrueshme dhe Marrëveshja e Ballkanit Perëndimor për Financimin të Drejtpërdrejtë të Energjisë së Qëndrueshme, si dhe garanci për ndarjen e riskut për humbjet e para në kuadrin e Fondit të Zhvillimit të Infrastrukturës Bashkiake.

Vëmendja e granteve të donatorëve pritet të mbetet në përmirësimin e infrastrukturës, vazhdimin e reformave dhe rritjen e konkurrueshmërisë së SME-ve. Për t'i përballuar këto nevoja, BERZH-i do të mbështetet tek disa fonde donatorësh të administruara nga Banka, përveç burimeve që i janë vënë në dispozicion nga aksionerët e tij:

- **Bashkimi Evropian** ka mbështetur aktivitetet e BERZH-it në Shqipëri që prej vitit 2008. Përmes Ndihmës së Instrumentit të Parapranimit (IPA), ai ka kanalizuar përmes Bankës mbi 54 milionë euro si grante për bashkëpunim teknik dhe jo-teknik për të përmirësuar rrjetin rrugor si dhe për të mbështetur shërbimet këshillimore për MSME-të në kuadrin e programit të BERZH-it për Mbështetje për Bizneset e Vogla. Në kuadrin e IPA II (2014 – 2020) pritet që BE-ja të vazhdojë të luajë rol kryesor në mbështetjen e përparësive kombëtare dhe rajonale, të cilat synojnë të arrijnë zhvillimin social-ekonomik, përmirësimin mjedisor, lidhjet rajonale dhe progresin drejt anëtarësimit në BE. Mbështetja financiare në kuadrin e WBIF-së do të rritet dhe do të përdoret gjithnjë e më tepër për bashkëfinancimin e projekteve me interes rajonal, veçanërisht të atyre që mbështesin lidhjet ndërmjet vendeve të rajonit dhe ndërmjet rajonit dhe shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.
- **Donatorët bilateralë:** fonde grantesh do t'u kërkohen donatorëve bilateralë që kanë llogari të administruara nga BERZH-i dhe që kanë shprehur interes për mbështetjen e aktiviteteve në Shqipëri në të gjithë sektorët dhe fondet e të cilëve do të jepen për të plotësuar aktivitete e mbështetura në kuadrin e WBIF-së;
- **Fondi Special i Aksionerëve të BERZH-it (SSF)** i financuar nga të ardhurat neto të Bankës. SSF-ja është një instrument plotësues për burimet e donatorëve dhe do të ofrojë ndihmë për bashkëpunim teknik dhe jo-teknik në fusha ku mbështetja është e kufizuar ose mungon, kurdo që këto fusha mbeten përparësi për bankën, për të çuar përpara procesin e tranzicionit.

**ANGAZHIMET PËR BASHKËPUNIM TEKNIK NGA DONATORËT PËRMES  
BERZH-IT, 2011-2014\***

<b>Donatori</b>	<b>Angazhimi në TC (€)</b>
Republika Çeke	224,681
Fondi Special i Aksionerëve i BERZH-it	2,958,463
Fondi për Ballkanin Perëndimor i BERZH-it	1,952,000
BE-ja	414,353
Italia	816,015
Luksemburgu	1,597,825
<b>Totali</b>	<b>7,963,337</b>

**ANGAZHIMET PËR BASHKËPUNIM TEKNIK SIPAS SEKTORËVE PËRMES  
BERZH-IT, 2011-2014\***

<b>Sektori/Skuadra</b>	<b>Angazhimi për TC (€)</b>
Iniciativa e Biznesit të Vogël**	2,382,445
Iniciativa e Energjisë së Qëndrueshme ***	5,000
Institucionet financiare	719,610
Infrastruktura	4,481,600
Programi i Tranzicionit Ligjor	374,681
<b>Totali i përgjithshëm</b>	<b>7,963,337</b>

Shënim: Vlerat e angazhimeve bazuar në të dhënat e fundit të vitit, ose në fund të periudhës për secilin vit.

\* Reflekon statusin e angazhimeve deri më 31 dhjetor 2014

\*\* Kjo kategori sektori përfshin ndihmën e drejtpërdrejtë për SME-të dhe ndihmën e tërthortë përmes dialogut të politikave mes BERZH-it, autoriteteve dhe shoqatave tregtare/biznesit (p.sh. Këshillave të Investimeve)

\*\*\* Ky sektor përfshin Eficencën e Energjisë dhe Ndryshimet Klimaterike (E2C2)